



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2023-12/IA004

**Vendosi:** **Paneli i Dhomës së Gjykatës së Apelit**  
Gjykatëse Mishelë Pikar  
Gjykatës Emilio Gati  
Gjykatëse Nina Jorgensen

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 1 shtator 2025

**Gjuha origjinale:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Vendim mbi Apelin e Isni Kilajt kundër Vendimit të Tretë të Rishikimit të  
Paraburgimit**

---

**Zyrës së Prokurorit të Specializuar:**  
Kimbërli P. Uest

**Mbrojtjes së Hashim Thaçit:**  
Sofi Menegon

**Mbrojtjes së Bashkim Smakajt**  
Xhonatan Elistan Ris

**Mbrojtjes së Isni Kilajt:**  
Ian Eduards

**Mbrojtjes së Fadil Fazliut**  
Dejvid Jang

**Mbrojtjes së Hajredin Kuçit:**  
Aleksandër Admiral

**PANELI I DHOMËS SË GJYKATËS SË APELIT** i Dhomave të Specializuara të Kosovës (përkatësisht, "Paneli i Gjykatës së Apelit", "Paneli i Apelit" ose "Paneli" dhe "Dhomat e Specializuara")<sup>1</sup> në pajtim me nenin 33(1)(c) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullës 169 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave ("Rregullorja") ka marrë në shqyrtim apelin e parashtruar më 19 qershor 2025 nga z. Isni Kilaj (përkatësisht, "Apeli" dhe "Kilaj" ose "i akuzuari"),<sup>2</sup> kundër Vendimit të Tretë mbi Rishikimin e Paraburgimit të Isni Kilajt ("Vendimi i Apeluar").<sup>3</sup> Më 30 qershor 2025, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") u përgjigj se Apeli duhet të hidhet poshtë ("Përgjigjja").<sup>4</sup> Kilaj u kundërpërgjigj më 7 korrik 2025 ("Kundërpërgjigjja").<sup>5</sup>

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 2 nëntor 2023, Kilaj u arrestua në Kosovë në bazë të urdhrit të lëshuar nga ZPS-ja<sup>6</sup> dhe më 3 nëntor 2023, u transferua në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara ("objekti i paraburgimit") në Hagë, Holandë.<sup>7</sup>

---

<sup>1</sup> IA004/F00002, Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit, 23 qershor 2025 (konfidencial, riklasifikuar si publik më 22 korrik 2025).

<sup>2</sup> IA004/F00001/RED, Version i Redaktuar Publik i Apelit të Kilajt kundër Vendimit të Tretë mbi Rishikimin e Paraburgimit të Isni Kilajt (F00324), 1 korrik 2025 (versioni konfidencial u dorëzua më 19 qershor 2025) ("Apeli").

<sup>3</sup> F00324, Vendimi i Tretë mbi Rishikimin e Paraburgimit të Isni Kilajt, 5 qershor 2025 ("Vendimi i Apeluar").

<sup>4</sup> IA004/F00003, Përgjigje e Prokurorisë ndaj Apelit të Kilajt kundër Vendimit të Tretë mbi Rishikimin e Paraburgimit të Isni Kilajt (F00324), 30 qershor 2025, (konfidencial) ("Përgjigjja").

<sup>5</sup> IA004/F00004, Kundërpërgjigje e Kilajt ndaj Përgjigjes së Prokurorisë lidhur me Apelin e Kilajt kundër Vendimit të Tretë mbi Rishikimin e Paraburgimit të Isni Kilajt (F00324), 7 korrik 2025, (konfidenciale) ("Kundërpërgjigjja").

<sup>6</sup> INV/F00039, Njoftim URJENT sipas Rregullës 52(1) për Arrestimin e Isni KILAJT, 2 nëntor 2023 (rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, riklasifikuar si publik më 9 nëntor 2023; INV/F00042/RED/A01/RED, Version i Redaktuar Publik i SHTOJCËS 1 të Raportit të Prokurorisë për Arrestimin e Isni KILAJT, 8 nëntor 2023 (versioni rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* u dorëzua më 3 nëntor 2023, riklasifikuar si konfidencial më 3 nëntor 2023).

<sup>7</sup> INV/F00045/RED, Version i Redaktuar Publik i Raportit për Transferimin e Isni Kilajt në Objektin e Paraburgimit, me Shtojcat 1-2, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* (F00495), 8 nëntor 2023 (versioni rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* u dorëzua më 3 nëntor 2023; INV/F00043, Njoftim për Pranimin e Isni Kilajt në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara, 3 nëntor 2023 (rreptësisht konfidencial, shënuar si *ex parte* me 27 janar 2025, riklasifikuar si publik më 4 mars 2025).

2. Më 6 nëntor 2023, Gjykatësi i Vetëm urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të Kilajt ("Vendimi i Parë mbi Paraburgimin në Çështjen 18-01").<sup>8</sup> Në vijim, më 5 janar 2024, Gjykatësi i Vetëm shqyrtoi dhe urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të Kilajt ("Vendimi i Dytë mbi Paraburgimin në Çështjen 18-01")<sup>9</sup> dhe më 5 mars 2024.<sup>10</sup> Vendimi i Parë mbi Paraburgimin dhe Vendimi i Dytë mbi Paraburgimin u konfirmuan nga Paneli i Gjykatës së Apelit (përkatësisht, "Vendimi i Parë i Apelit mbi Paraburgimin në Çështjen 18-01"<sup>11</sup> dhe "Vendimi i Dytë i Apelit mbi Paraburgimin në Çështjen 18-01").<sup>12</sup>

3. Më 15 dhjetor 2023, ZPS-ja i dorëzoi për konfirmim Gjykatësit të Procedurës Paraprake aktakuzën kundër disa personave, ndër të cilët Kilaj,<sup>13</sup> dhe më 11 mars 2024, dorëzoi aktakuzën e rishikuar ("Aktakuza e Rishikuar").<sup>14</sup>

---

<sup>8</sup> INV/F00049, Vendim mbi Vazhdimin e Paraburgimit, 6 nëntor 2023 (Vendimi mbi Vazhdimin e Paraburgimit). Gjykatësi i Vetëm paraqiti arsyet për atë vendim më 9 nëntor 2023. Shih INV/F00053/RED, Version i Redaktuar Publik i Arsyeve për Vazhdimin e Paraburgimit, 13 nëntor 2023 (versioni konfidencial u dorëzua më 9 nëntor 2023) ("Arsyet për Vazhdimin e Paraburgimit"). Paneli i Apelit do t'u referohet bashkërisht Vendimit mbi Vazhdimin e Paraburgimit dhe Arsyeve për Vazhdimin e Paraburgimit si "Vendimi i Parë mbi Paraburgimin në Çështjen 18-01".

<sup>9</sup> INV/F00068/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit të Isni Kilajt, 18 janar 2024 (versioni konfidencial u dorëzua më 5 janar 2024) ("Vendimi i Dytë mbi Paraburgimin në Çështjen 18-01").

<sup>10</sup> INV/F00098/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit të Isni Kilajt, 11 mars 2024 (versioni konfidencial u dorëzua më 5 mars 2024) ("Vendimi i Tretë mbi Paraburgimin në Çështjen 18-01").

<sup>11</sup> INV/F00250/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Isni Kilajt kundër Vendimit mbi Vazhdimin e Paraburgimit, 11 janar 2024 (versioni konfidencial u dorëzua më 11 janar 2024) ("Vendimi i Parë i Apelit mbi Paraburgimin në Çështjen 18-01").

<sup>12</sup> INV/F00256/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Isni Kilajt kundër Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit, 26 shkurt 2024 (versioni konfidencial u dorëzua më 26 shkurt 2024) ("Vendimi i Dytë i Apelit mbi Paraburgimin në Çështjen 18-01").

<sup>13</sup> F00002, Parashtrim i Aktakuzës për Konfirmim dhe Kërkesave lidhur me Të, 15 dhjetor 2023 (rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, riklasifikuar si konfidencial më 13 mars 2025).

<sup>14</sup> F00007, Parashtrim i Aktakuzës së Rishikuar për Konfirmim, 11 mars 2024 (rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, riklasifikuar si konfidencial më 13 mars 2025); F00007/A01 Shtojca 1 e Parashtrimit të Aktakuzës së Rishikuar për Konfirmim, 11 mars 2024 (rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, riklasifikuar si konfidenciale më 13 mars 2025). Shih gjithashtu F00004, Urdhër Prokurores së Specializuar sipas Rregullës 86(4) të Rregullores, 22 shkurt 2024 (rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, riklasifikuar si konfidencial më 13 mars 2025).

4. Më 2 maj 2024, ZPS-ja kërkoi, ndër të tjera, pezullimin e shqyrtimit të Aktakuzës së Rishikuar prej Gjykatësit të Procedurës Paraprake deri në dorëzimin e materialit mbështetës shtesë dhe të aktakuzës së ndryshuar ("Kërkesa e ZPS-së për Leje dhe Pezullim").<sup>15</sup>
5. Më 3 maj 2024, Gjykatësi i Vetëm urdhëroi lirimin e Kilajt në Kosovë, me kushte të rrepta, pasi e konstatoi të paarsyeshëm vazhdimin e paraburgimit të tij, në pritje të shqyrtimit të Kërkesës së ZPS-së për Leje dhe Pezullim, dhe, rrjedhimisht, në pritje të dorëzimit të aktakuzës së ndryshuar më tej ndaj Kilajt ("Vendimi për Lirimin në Çështjen 18-01").<sup>16</sup> Vendimi për Lirimin në Çështjen 18-01 u konfirmua nga Paneli i Apelit më 13 maj 2024,<sup>17</sup> dhe Kilaj u transferua në Kosovë dhe u lirua nga paraburgimi i Dhomave të Specializuara më 15 maj 2024.<sup>18</sup>
6. Më 20 qershor 2024, Gjykatësja e Procedurës Paraprake rrëzoi Kërkesën e ZPS-së për Leje dhe Pezullim.<sup>19</sup>
7. Më 28 qershor 2024, ZPS-ja paraqiti për konfirmim aktakuzën e ndryshuar kundër z. Hashim Thaçi, z. Bashkim Smakaj, Kilajt, z. Fadil Fazliu, dhe z. Hajredin

---

<sup>15</sup> F00014, Parashtrime të Prokurorisë sipas Urdhrit F00011, 2 maj 2024 (rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, riklasifikuar si konfidenciale më 13 mars 2025). Paneli thekson se, më të njëjtën ditë, ZPS-ja gjithashtu informoi zyrtarisht Gjykatësin e Vetëm për kërkesën dhe synimin e vet për të dorëzuar aktakuzën e ndryshuar. Shih INV/F00126, Njoftim Plotësues i Prokurorisë, 2 maj 2024 (konfidencial, shënuar si *ex parte* më 27 janar 2025, riklasifikuar si publik më 8 maj 2025). Shih gjithashtu INV/F00115, Njoftim i Prokurorisë, 19 prill 2024 (konfidencial, riklasifikuar si publik më 5 qershor 2024).

<sup>16</sup> INV/F00129/COR/RED, Version i Redaktuar Publik i Versionit të Korrigjuar të Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit të Isni Kilajt, 15 maj 2024 (versioni konfidencial i pakorrigjuar u dorëzua më 3 maj 2024, versioni konfidencial i korrigjuar u dorëzua më 15 maj 2024), ("Vendimi për Lirimin në Çështjen 18-01"), para. 64-65, 70(a), (c)

<sup>17</sup> INV/F00273/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Zyrës së Prokurorit të Specializuar kundër Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit të Isni Kilajt, 15 maj 2024, (versioni konfidencial u dorëzua më 13 maj 2024), ("Vendimi i Apelit në lidhje me Lirimin në Çështjen 18-01").

<sup>18</sup> INV/F00274, Njoftim për Transferimin e Isni Kilajt në Kosovë, 15 maj 2024 (konfidencial, riklasifikuar si publik më 7 gusht 2024).

<sup>19</sup> F00016, Vendim mbi Kërkesat e Prokurorisë për Leje për të Paraqitur Material Shtesë dhe për Pezullimin e Shqyrtimit të Aktakuzës, 20 qershor 2024 (rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, riklasifikuar si publik më 13 mars 2025).

Kuçi (bashkërisht, "pesë të akuzuarit").<sup>20</sup> Më 12 nëntor 2024, në bazë të urdhrit të lëshuar nga Gjykatësja e Procedurës Paraprake, ZPS-ja dorëzoi për konfirmim aktakuzën e ndryshuar më tej.<sup>21</sup>

8. Më 29 nëntor 2024, Gjykatësja e Procedurës Paraprake lëshoi Vendimin e Konfirmimit, me të cilin konfirmoi pjesërisht akuzat ndaj pesë të akuzuarve.<sup>22</sup> Në veçanti, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konfirmoi akuzat kundër Kilajt për tentativë për pengim, me anë të veprimit të përbashkët të një grupi, të personave zyrtarë, përfshirë prokurorë dhe hetues të ZPS-së, në kryerjen e detyrave zyrtare, e ndëshkueshme në bazë të neneve 17, 21, 33, 35 dhe 40(2) dhe (5) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Kodi nr. 06/L-074 (2019) ("KPK"), dhe neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit; dhe për mosbindje ndaj gjykatës, e ndëshkueshme në bazë të neneve 21, 33 dhe 393 të KPK-së, dhe neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit.<sup>23</sup>

9. Po të njëjtën ditë, me kërkesë të ZPS-së,<sup>24</sup> Gjykatësja e Procedurës Paraprake ndërpreu lirimin me kusht të Kilajt në Kosovë, lëshoi fletarrestimin dhe urdhëroi transferimin e tij në objektin e paraburgimit.<sup>25</sup>

---

<sup>20</sup>F00017, Parashtrim i Aktakuzës së Ndryshuar për Konfirmim, 28 qershor 2024 (rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, riklasifikuar si konfidencial më 13 mars 2025); F00017/A01, Shtojcë e Parashtrimit të Aktakuzës së Ndryshuar për Konfirmim, 28 qershor 2024 (rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, riklasifikuar konfidenciale më 13 mars 2025).

<sup>21</sup> F00028/RED, Version i Redaktuar Publik i Parashtrimit të Aktakuzës së Ndryshuar më Tej për Konfirmim me Shtojcat 1-2, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, 4 shkurt 2025 (versioni rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* u dorëzua më 12 nëntor 2024, riklasifikuar si konfidencial më 13 janar 2025); F00028/A01, Shtojca 1 e Parashtrimit të Aktakuzës së Ndryshuar më Tej për Konfirmim, 12 nëntor 2024 (rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, riklasifikuar si publike më 13 janar 2025).

<sup>22</sup> F00036/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Konfirmimin e Aktakuzës, 12 shkurt 2025 (versioni rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* u dorëzua më 29 nëntor 2024, dhe u riklasifikua si konfidencial më 13 dhjetor 2024) ("Vendimi i Konfirmimit").

<sup>23</sup> Vendimi i Konfirmimit, para. 313(d). Shih gjithashtu Vendimin e Apeluar, para. 22.

<sup>24</sup> F00023/RED, Version i Redaktuar Publik i Parashtrimeve të Prokurorisë në bazë të Urdhrit F00022 me Shtojcat 1-5, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, 13 dhjetor 2024 (versioni rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* u dorëzua më 17 tetor 2024, riklasifikuar si konfidencial më 6 dhjetor 2024). Shih gjithashtu F00022/RED, Version i Redaktuar Publik i Urdhrit për Parashtrime, 17 mars 2025 (versioni rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* u dorëzua më 8 tetor 2024, riklasifikuar si konfidencial më 13 mars 2025).

<sup>25</sup> F00037/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën për Lëshimin e Fletarrestimeve dhe Çështje Përkatese, 19 dhjetor 2024 (versioni rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* u dorëzua më 29

10. Më 2 dhjetor 2024, ZPS-ja dorëzoi aktakuzën e konfirmuar.<sup>26</sup>
11. Më 5 dhjetor 2024, Kilaj u arrestua në Kosovë dhe, më 6 dhjetor 2024, u transferua në objektin e paraburgimit.<sup>27</sup>
12. Më 9 dhjetor 2024, në paraqitjen e parë të z. Kilaj,<sup>28</sup> Gjykatësja e Procedurës Paraprake urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të tij ("Vendimi mbi Paraburgimin").<sup>29</sup> Më 28 janar 2025, Paneli i Gjykatës së Apelit hodhi poshtë apelin e Kilajt kundër Vendimit mbi Paraburgimin ("Vendimi i Apelit në lidhje me Vazhdimin e Paraburgimit").<sup>30</sup>
13. Gjykatësja e Procedurës Paraprake më pas rishikoi dhe vazhdoi paraburgimin e Kilajt çdo dy muaj deri në fazën aktuale.<sup>31</sup>

---

nëntor 2024, riklasifikuar si konfidencial më 6 dhjetor 2024), para. 68; F00037/A03, Fletarrestim për Isni Kilajn, 29 nëntor 2024 (rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*).

<sup>26</sup> F00055, Parashtrim i Versionit të Redaktuar Publik të Aktakuzës së Konfirmuar, 6 dhjetor 2024; F00055/A01, Shtojca 1 e Parashtrimit të Versionit të Redaktuar Publik të Aktakuzës së Konfirmuar, 6 dhjetor 2024 ("Aktakuza e Konfirmuar"). Shih gjithashtu F00040, Parashtrim i Aktakuzës së Konfirmuar, 2 dhjetor 2024 (rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, riklasifikuar si rreptësisht konfidencial më 3 dhjetor 2024). F00040/A01, Shtojca 1 e Parashtrimit të Aktakuzës së Konfirmuar, 2 dhjetor 2024 (rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, riklasifikuar si rreptësisht konfidenciale më 3 dhjetor 2024).

<sup>27</sup> F00067/RED, Version i Redaktuar Publik i Raportit për Arrestimin dhe Transferimin e Isni Kilajt në Objektin e Paraburgimit, 10 janar 2025 (versioni rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* u dorëzua më 8 dhjetor 2024, riklasifikuar si konfidencial dhe *ex parte* më 17 dhjetor 2024); F00056, Njoftim për Pranimin e Isni Kilajt në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara, 6 dhjetor 2024 (rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, riklasifikuar si publik më 17 dhjetor 2024).

<sup>28</sup> Transkripti, 9 dhjetor 2024, f. 85-125 ("Transkripti i Paraqitjes së Parë").

<sup>29</sup> Transkripti i Paraqitjes së Parë, f. 120-124.

<sup>30</sup> IA001/F00005, Vendim mbi Apelin e Isni Kilajt kundër Vendimit mbi Vazhdimin e Paraburgimit, 28 janar 2025 ("Vendimi i Apelit në lidhje me Vazhdimin e Paraburgimit").

<sup>31</sup> F00162, Vendim mbi Rishikimin e Paraburgimit të Isni Kilajt, 7 shkurt 2025 ("Vendimi i Parë i Rishikimit"); F00248, Vendimi i Dytë mbi Rishikimin e Paraburgimit të Isni Kilajt, 7 prill 2025 (Vendimi i Dytë i Rishikimit").

14. Më 16 prill 2025, në vijim të vendimit të Gjykatësës së Procedurës Paraprake për ndryshimin e Vendimit të Konfirmimit, ZPS-ja dorëzoi aktakuzën e konfirmuar të ndryshuar ("Aktakuza e Konfirmuar e Ndryshuar").<sup>32</sup>

15. Më 5 qershor 2025, pasi mori parashtrimet e palëve,<sup>33</sup> Gjykatësja e Procedurës Paraprake lëshoi Vendimin e Apeluar, me të cilin urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të Kilajt, mbi bazën e vazhdimin të ekzistencës, ndër të tjera, të dyshimit të bazuar për kryerje prej Kilajt të krimeve brenda juridiksionit lëndor të Dhomave të Specializuara dhe rreziqeve që Kilaj të pengojë ecurinë e proceseve të Dhomave të Specializuara apo të kryejë vepra penale të tjera.<sup>34</sup> Gjykatësja e Procedurës Paraprake gjithashtu konstatoi se as lirimi i përkohshëm me kusht i propozuar prej Kilajt, dhe as ndonjë kusht tjetër i arsyeshëm i vendosur prej Gjykatësës së Procedurës Paraprake, nuk do të zvogëlonin mjaftueshëm rrezikun e pengimit të ecurisë së procesit të Dhomave të Specializuara apo rrezikun e kryerjes së krimeve të tjera.<sup>35</sup>

16. Më 27 qershor 2025, në bazë të urdhrit të Gjykatësës së Procedurës Paraprake,<sup>36</sup> Kilaj bëri të ditur se nuk hiqte dorë nga e drejta për rishikimin çdo dy muaj të paraburgimit të tij, sipas afateve kalendarike, derisa Paneli i Apelit të lëshonte një

---

<sup>32</sup> F00264, Parashtrim i Aktakuzës së Konfirmuar të Ndryshuar, 16 prill 2025; F00264/A02, Shtojca 2 e Parashtrimit të Aktakuzës së Konfirmuar të Ndryshuar, 16 prill 2025. Shih gjithashtu F00260, Vendim për Ndryshimin e Vendimit mbi Konfirmimin e Aktakuzës dhe Caktimin e Datës për Dorëzimin e Mocioneve Paraprake, 14 prill 2025.

<sup>33</sup> F00280/RED, Version i Redaktuar Publik i Parashtrimeve të Kilajt në lidhje me Rishikimin e Paraburgimit (versioni konfidencial u dorëzua më 5 maj 2025) ("Parashtrimet e Mbrojtjes para Gjykatësës së Procedurës Paraprake"); F00302, Përgjigje e Prokurorisë ndaj Parashtrimeve të Kilajt në lidhje me Rishikimin e Paraburgimit, 14 maj 2025 (konfidenciale, riklasifikuar si publike më 5 qershor 2025); F00307, Kundërpërgjigje ndaj Përgjigjes së Prokurorisë për Parashtrimet e Kilajt në lidhje me Rishikimin e Paraburgimit, 19 maj 2025.

<sup>34</sup> Vendimi i Apeluar, para. 23, 29, 33, 35, 36.

<sup>35</sup> Vendimi i Apeluar, para. 37-38, 40. Kilaj propozoi të paguante një garanci financiare në shumën prej 40.000 eurosh. Shih Parashtrimet e Mbrojtjes para Gjykatësës së Procedurës Paraprake, para. 55. Kilaj e ka propozuar edhe më parë këtë shumë si dorëzani, si dhe paraqitje të shpeshta të tij në policinë e Kosovës dhe kufizime në komunikime dhe lëvizje. Shih gjithashtu Vendimin e Dytë të Rishikimit, para. 36-39; Vendimin e Parë të Rishikimit, para. 32-36; Transkriptin e Paraqitjes së Parë, f. 123-124; Vendimin për Lirimin në Çështjen 18-01, para. 51, 64-66.

<sup>36</sup> F00348, Urdhër në Lidhje me Rishikimin e Ardhshtëm të Paraburgimit të Isni Kilajt, 25 qershor 2025, para. 5.

vendim në lidhje me apelin e tij.<sup>37</sup> Më 5 gusht 2025, Gjykatësja e Procedurës Paraprake lëshoi një vendim të ri në lidhje me rishikimin e paraburgimit të Kilajt.<sup>38</sup>

## II. STANDARDI I SHQYRTIMIT

17. Paneli i Gjykatës së Apelit zbaton standardin e shqyrtimit për apelet e ndërmjetme të përcaktuar në vendimin e tij të parë dhe të zbatuar në vijimësi.<sup>39</sup>

## III. PARASHTRIMET PUBLIKE

18. Paneli i Apelit vëren se Vendimi i Apeluar u dorëzua me klasifikimin si publik. Ndonëse fillimisht Kilaj e dorëzoi Apelin si konfidencial, më pas, më 1 korrik 2025, u dorëzua versioni i redaktuar publik i Apelit. Përgjigja dhe Kundërpërgjigja u dorëzuan si konfidenciale në përputhje me rregullën 82(4) të Rregullores, por palët vunë në dukje se këto parashtrime të protokolluara mund të riklasifikoheshin si publike, pasi nuk përmbanin informacion konfidencial.<sup>40</sup> Paneli rikujton se të gjitha parashtrimet e protokolluara para Dhomave të Specializuara duhet të jenë publike, përveç kur ka arsye të posaçme për t'i mbajtur konfidenciale, dhe se palët duhet të dorëzojnë për protokollim versione të redaktuara publike të të gjitha parashtrimeve

---

<sup>37</sup> F00353, Parashtrim në përputhje me Urdhrin në lidhje me Rishikimin e Ardhshëm të Paraburgimit të Isni Kilajt (F00348), 27 qershor 2025.

<sup>38</sup> Vendimi i Katërt mbi Rishikimin e Paraburgimit të Isni Kilajt, 5 gusht 2025.

<sup>39</sup> KSC-BC-2020-07, IA001/F00005, Vendim mbi Apelin e Hysni Gucati për Çështje të lidhura me Arrestimin dhe Mbajtjen e Tij në Paraburgim, 9 dhjetor 2020, ("Vendimi i Apelit *Gucati*"), para. 4-14. Shih gjithashtu Vendimin e Apelit në lidhje me Vazhdimin e Paraburgimit, para. 15-17.

<sup>40</sup> Përgjigja, para. 32; Kundërpërgjigja, para. 2.

që i paraqesin Panelit.<sup>41</sup> Rrjedhimisht, Paneli urdhëron që Përgjigja dhe Kundërpërgjigja të riklasifikohen si publike.

#### IV. DISKUTIM

##### A. PRETENDIMI PËR ZBATIM TË PASAKTË TË STANDARDIT TË DUHUR PËR PARABURGIMIN (PIKA 1)

###### 1. Parashtrimet e palëve

19. Kilaj argumenton se Gjykatësja e Procedurës Paraprake zbatoi një "metodologji të gabuar dhe të papërshtatshme për vlerësimin e rrethanave relevante dhe zbatimin e tyre sipas standardeve të duhura për paraburgimin".<sup>42</sup> Konkretisht, sipas Kilajt, Gjykatësja e Procedurës Paraprake: (i) "nuk zbatoi prezumimin në favor të lirisë; (ii) nuk kreu një vlerësim të ri dhe të përditësuar të rrethanave; dhe (iii) nuk bëri konstatime konkrete të bazuara në prova".<sup>43</sup>

20. Në mbështetje të argumentit të vet se Gjykatësja e Procedurës Paraprake nuk zbatoi prezumimin në favor të lirisë, Kilaj argumenton se ndonëse paraburgimi është një përjashtim nga e drejta për liri, bazuar në rezultatet e vendimeve për lirim të përkohshëm në Dhomat e Specializuara, "përjashtimi është bërë rregull", pasi shumica dërrmuese e të akuzuarve mbahen në paraburgim sikur kjo të ishte diçka e natyrshme.<sup>44</sup> Kilaj rikujton se Dhomat e Specializuara kanë detyrime sipas instrumenteve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, siç është Konventa Evropiane

---

<sup>41</sup> Shih p.sh., KSC-BC-2020-06, IA008/F00004/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Kadri Veselit kundër Vendimit të Rishikimit të Paraburgimit, 1 tetor 2021 (versioni konfidencial u dorëzua më 1 tetor 2021) ("Vendimi i Parë i Apelit mbi Paraburgimin e Veselit"), para. 8-9. Shih gjithashtu KSC-CA-2022-01, F00103, Vendim mbi Kërkesën e Gucatit për Riklasifikim ose Versione të Redaktuara Publike të Vendimeve të Panelit të Gjykatës së Apelit, 9 janar 2023, para. 2.

<sup>42</sup> Apeli, para. 36. Shih gjithashtu Apelin, para. 50.

<sup>43</sup> Apeli, para. 36.

<sup>44</sup> Apeli, para. 37-38.

për të Drejtat e Njeriut ("KEDNJ"), ku përcaktohet prezumimi në favor të lirimit gjatë fazës së paraburgimit.<sup>45</sup>

21. Kilaj gjithashtu argumenton se Gjykatësja e Procedurës Paraprake duhej të kishte kryer një "vlerësim të ri [ose *de novo*]" të zbatueshmërisë së arsyeve për refuzimin e lirimit.<sup>46</sup> Megjithatë, sipas tij, Gjykatësja e Procedurës Paraprake nuk e bëri një vlerësim të tillë por u mbështet në konstatime të bëra në vendime të mëhershme, duke arritur kështu në përfundimin e gabuar se "faktorët e favorshëm për z. Kilaj nuk e zvogëlojnë mjaftueshëm rrezikun" në fjalë.<sup>47</sup> Kilaj argumenton se ky konstatim, i cili "u përsërit pikë më pikë në lidhje me arsyet e tjera", ia ngarkon në mënyrë të padrejtë të akuzuarit barrën e vërtetimit të mungesës së rrezikut.<sup>48</sup> Kilaj gjithashtu argumenton se, në kundërshtim me qasjen e përcaktuar nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ("GJEDNJ"), që kërkon një "vlerësim të ri" të rrethanave që përlligjin vazhdimin e paraburgimit, Gjykatësja e Procedurës Paraprake vlerësoi vetëm nëse ndonjë "rrethanë e re" kundërshtonte konstatimet e mëhershme të saj.<sup>49</sup>

22. Së fundi, Kilaj parashton se Gjykatësja e Procedurës Paraprake u mbështet në "konstatime abstrakte dhe stereotipe" për të refuzuar lirimin e përkohshëm.<sup>50</sup> Në mbështetje të këtij argumenti, Kilaj parashton se, në lidhje me rrezikun e arratisjes, Gjykatësja e Procedurës Paraprake i dha rëndësi "peshës së veprave penale", "njohurisë së Kilajt për provat e paraqitura prej ZPS-së" dhe "mundësisë së marrjes së një dënimi të rëndë", pa shtjelluar provat mbështetëse mbi të cilat u bënë këto konstatime dhe pa iu referuar "kuadrit faktik konkret që mbështet akuzat" me të cilat përballet Kilaj.<sup>51</sup>

---

<sup>45</sup> Apeli, para. 39.

<sup>46</sup> Apeli, para. 40. Shih gjithashtu Kundërpërgjigjen, para. 3-4, 10.

<sup>47</sup> Apeli, para. 41. Shih gjithashtu Apelin, para. 42.

<sup>48</sup> Apeli, para. 43.

<sup>49</sup> Apeli, para. 44-46. Shih gjithashtu, Kundërpërgjigjen, para. 10.

<sup>50</sup> Apeli, para. 47-50.

<sup>51</sup> Apeli, para. 47.

23. ZPS-ja përgjigjet se argumentet e Kilajt shtrembërojnë Vendimin e Apeluar,<sup>52</sup> dhe se, duke pasur parasysh konstatimet e bazuara të Gjykatës së Procedurës Paraprake, përmendja prej tij e jurisprudencës së GJEDNJ-së, është e pavend dhe "e pabazë".<sup>53</sup>

24. Së pari, ZPS-ja përgjigjet se, sikurse është shprehur vazhdimisht Dhoma e Gjykatës së Apelit, Gjykatësja e Procedurës Paraprake nuk kishte detyrimin të bëjë konstatime në lidhje me faktorë për të cilat tashmë ishte marrë vendim më parë; por, e rëndësishme ishte që ajo të bindej se këta faktorë relevantë vazhdonin të ekzistonin në kohën e kryerjes së rishikimit prej saj.<sup>54</sup>

25. Së dyti, ZPS-ja përgjigjet se faktorët në të cilët mbështetet Vendimi i Apeluar janë konkretë dhe të individualizuar.<sup>55</sup> ZPS-ja argumenton se Kilaj bën parashtrime konkrete vetëm në lidhje me faktorët që mbështesin rrezikun e arratisjes dhe se konkretë dhe specifikë për Kilajn janë edhe faktorët që ai kundërshton, si lloji i akuzave ose ashpërsia e dënimit.<sup>56</sup>

26. ZPS-ja gjithashtu përgjigjet se (i) argumentet e Kilajt në lidhje me zhvendosjen e përgjegjësisë së vërtetimit, janë të pathemelta,<sup>57</sup> (ii) pretendimi i tij se Gjykatësja e Procedurës Paraprake nuk zbatoi prezumimin e të drejtës së personit për liri, është i pambështetur;<sup>58</sup> dhe (iii) në përgjithësi, Kilaj nuk demonstroi ndonjë gabim.<sup>59</sup>

27. Në Kundërpërgjigje, në lidhje me nëse Gjykatësja e Procedurës Paraprake kishte detyrimin të kryente një vlerësim *de novo*, Kilaj parashtron se, ndonëse disa konstatime nuk ka të ngjarë të ndryshojnë me kalimin e kohës, për konstatime të tjera,

---

<sup>52</sup> Përgjigjja, para. 6.

<sup>53</sup> Përgjigjja, para. 11.

<sup>54</sup> Përgjigjja, para. 8. Shih gjithashtu Përgjigjen, paragrafët 7, 10.

<sup>55</sup> Përgjigjja, para. 9.

<sup>56</sup> Përgjigjja, para. 10.

<sup>57</sup> Përgjigjja, para. 12.

<sup>58</sup> Përgjigjja, para. 13.

<sup>59</sup> Përgjigjja, para. 14.

si rreziku i ndërhyrjes në prova, kërkohet një vlerësim i ri, të cilin Gjykatësja e Procedurës Paraprake nuk e bëri.<sup>60</sup> Duke u mbështetur në jurisprudencën e Dhomës së Gjykatës së Apelit, Kilaj gjithashtu kundërpërgjigjet se përmendja e vendimeve të marra në të kaluarën për kushte "statike", është e lejueshme por "lidhet me pyetjen themelore, parësore dhe 'thelbësore'" se "a ekzistojnë ende arsyet për vazhdimin e paraburgimit në kohën e marrjes së vendimit të rishikimit".<sup>61</sup>

## 2. Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

28. Fillimisht, Paneli vëren se, në mbështetje të pretendimit të përgjithshëm të tij se Gjykatësja e Procedurës Paraprake nuk zbatoi prezumimin në favor të lirimit para gjykimit të tij, Kilaj kundërshton rezultatin e vendimeve për lirim të përkohshëm në Dhomat e Specializuara, në vend që të paraqesë argumente konkrete në lidhje me paraburgimin e vet.<sup>62</sup> Paneli vëren se pretendimi i pambështetur i Kilajt nuk demonstroi se Gjykatësja e Procedurës Paraprake gaboi në vlerësimin e saj. Paneli rikujton se një panel mund të rrëzojë menjëherë argumentet që nuk kanë gjasë të shkaktojnë prapësimin ose ndryshimin e vendimit të apeluar dhe nuk ka nevojë të shqyrtohen në lidhje me themelësinë.<sup>63</sup> Rrjedhimisht, Paneli rrëzon argumentin e Kilajt në lidhje me këtë aspekt.

29. Në lidhje me argumentin e Kilajt se Gjykatësja e Procedurës Paraprake nuk kreu një vlerësim *de novo* të rrethanave që përlligjin vazhdimin e paraburgimit,<sup>64</sup> Kilaj i referohet specifikisht vlerësimit prej Gjykatës së Procedurës Paraprake të rrezikut të arratisjes.<sup>65</sup> Më parë, Dhoma e Gjykatës së Apelit ka përcaktuar se:

---

<sup>60</sup> Kundërpërgjigjja, para. 5-7, 15-16.

<sup>61</sup> Kundërpërgjigjja para. 8-9.

<sup>62</sup> Shih Apelin, para. 38-39, 50.

<sup>63</sup> Shih p.sh., KSC-CA-2024-03, F00069/RED, Version i Redaktuar Publik i Aktgjykimit të Apelit, 14 korrik 2025 (versioni konfidencial u dorëzua më 14 korrik 2025), para. 42.

<sup>64</sup> Shih Apelin, para. 40-46. Shih gjithashtu Kundërpërgjigjen, para. 3-4, 10.

<sup>65</sup> Shih Apelin, para. 41-43, që u referohen paragrafëve 27, 30, 34 të Vendimit të Apeluar. Në Kundërpërgjigje, Kilaj gjithashtu kundërshton vlerësimin prej Gjykatës së Procedurës Paraprake të

Paneli kompetent ka detyrimin të rishikojë arsyet ose rrethanat që mbështesin paraburgimin dhe të përcaktojë nëse këto arsye vazhdojnë të ekzistojnë sipas nenit 41(6) të Ligjit. Paneli kompetent nuk ka detyrimin të bëjë konstatime në lidhje me faktorë për të cilët është marrë tashmë vendim në vendimin e parë mbi paraburgimin, por duhet të shqyrtojë arsyet ose rrethanat në fjalë dhe të përcaktojë nëse ato ende ekzistojnë. Thelbësore është që paneli kompetent të bindet se në kohën e marrjes së vendimit mbi rishikimin e paraburgimit, ende ekzistojnë arsyet për vazhdimin e paraburgimit.<sup>66</sup>

30. Në këtë aspekt, Paneli gjithashtu rikujton se nuk është i lehtë detyrimi për të përcaktuar nëse "ende ekzistojnë" rrethanat që mbështesin paraburgimin.<sup>67</sup> Ai vendos mbi panelin kompetent detyrën që të vlerësojë *proprio motu* nëse është ende i bindur se paraburgimi i të akuzuarit mbetet i përligjur në kohën e marrjes së vendimit të rishikimit dhe duke marrë parasysh rrethanat e veçanta të çështjes.<sup>68</sup>

31. Paneli i Gjykatës së Apelit më parë ka konstatuar se ndonëse rishikimi i automatik çdo dy muaj sipas rregullës 57(2) të Rregullores nuk kufizohet rreptësisht në faktin nëse ka ndodhur apo jo një ndryshim në rrethanat e çështjes, ky ndryshim gjithsesi mund të jetë vendimtar dhe do të merret parasysh nëse ngrihet para Panelit ose *proprio motu*.<sup>69</sup> Paneli i Apelit më tej gjykon se një panel mund t'u referohet konstatimeve të bëra në vendimet e mëparshme, nëse bindet se provat ose

---

rrezikut të ndërhyrjes në prova në këtë çështje. Shih Kundërpërgjigjen, para. 5-7. Paneli këto argumente i ka trajtuar së bashku me argumentet e tjera të paraqitura nga Kilaj në Pikën 3 të Apelit. Shih më poshtë, para. 66-84.

<sup>66</sup> KSC-BC-2020-07, IA002/F00005, Vendim mbi Apelin e Nasim Haradinajt kundër Vendimit në lidhje me Rishikimin e Paraburgimit, 9 shkurt 2021, para. 55; KSC-BC-2020-04, IA003/F00005/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Pjetër Shalës kundër Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit, 11 shkurt 2022 (versioni konfidencial u dorëzua më 11 shkurt 2022) ("Vendimi i Dytë i Apelit mbi Paraburgimin e Shalës"), para. 16, 18.

<sup>67</sup> Vendimi i Dytë i Apelit mbi Paraburgimin e Shalës, para. 17. Shih gjithashtu nenin 41(10) të Ligjit: "nëse ekzistojnë ende arsyet për paraburgim".

<sup>68</sup> Vendimi i Dytë i Apelit mbi Paraburgimin e Shalës, para. 17.

<sup>69</sup> Shih p.sh. Vendimin e Dytë të Apelit mbi Paraburgimin e Shalës, para. 18; KSC-BC-2020-06, IA008/F0004/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Kadri Veselit kundër Vendimit të Rishikimit të Paraburgimit, 1 tetor 2021 (versioni konfidencial u dorëzua më 1 tetor 2021) ("Vendimi i Dytë i Apelit mbi Paraburgimin e Veselit"), para. 15; KSC-BC-2020-06, IA010/F00008/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit të Rishikimit të Paraburgimit, 27 tetor 2021 (versioni konfidencial u dorëzua më 27 tetor 2021) ("Vendimi i Dytë i Apelit mbi Paraburgimin e Thaçit"), para. 19.

informacioni mbi të cilët mbështeten ato vendime vazhdojnë të mbështesin konstatimet e bëra në kohën e rishikimit.<sup>70</sup> Gjithashtu, Paneli rikujton se nuk duhet të pritet që Gjykatësja e Procedurës Paraprake të shqyrtojë parashtrime të cilat vetëm përsërisin argumente tashmë të trajtuara në vendime të mëparshme.<sup>71</sup>

32. Në lidhje me konstatimin specifik të Gjykatësës së Procedurës Paraprake se "faktorët e favorshëm për z. Kilaj nuk e zvogëlojnë mjaftueshëm rrezikun e arratisjes",<sup>72</sup> Paneli është i mendimit se ky formulim është në përputhje me standardin që zbatohet në Dhomat e Specializuara, sipas të cilit një i akuzuar mund të paraburgoset vetëm në qoftë se masa më të buta *do të ishin të pamjaftueshme për të zvogëluar rreziqet e arratisjes, pengimit të procedurave ose kryerjes së krimeve të tjera.*<sup>73</sup> Në mbështetje të këtij konstatimi, Gjykatësja e Procedurës Paraprake mori parasysh faktorë të shumtë dhe iu referua në mënyrë të qartë argumenteve të paraqitura nga Kilaj,<sup>74</sup> por prapëseprapë konstatoi se faktorët e përcaktuar në Vendimin e Dytë të Rishikimit vijonin të ishin relevantë, veçanërisht në fazën aktuale që akuzat ndaj Kilajt janë konfirmuar.<sup>75</sup> Paneli i Gjykatës së Apelit konstaton se Gjykatësja e Procedurës Paraprake e ka përmbushur detyrimin e vet, pasi u bind se, në kohën e rishikimit të paraburgimit, rreziku i arratisjes vazhdonte të ekzistonte.

---

<sup>70</sup> Shih Vendimin e Dytë të Apelit mbi Paraburgimin e *Shalës*, para. 18; KSC-BC-2020-06, IA034/F00005/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Kadri Veselit kundër Vendimit mbi Kërkesën për Lirim të Përkohshëm, 13 gusht 2025 (versioni konfidencial u dorëzua më 13 gusht 2025) ("Vendimi i Katërt i Apelit mbi Paraburgimin e *Veselit*"), para. 34. Shih për ngjashmëri, ICC, *Prosecutor v. Gbagbo and Blé Goudé*, ICC-02/11-01/15-992-Red, Judgment on the appeal of Mr Laurent Gbagbo against the decision of Trial Chamber I of 10 March 2017 entitled "Decision on Mr Gbagbo's Detention", 19 July 2017, para. 39.

<sup>71</sup> Shih p.sh., Vendimin e Dytë të Apelit mbi Paraburgimin e *Shalës*, para. 18; Vendimin e Dytë të Apelit mbi Paraburgimin e *Veselit*, para. 16; Vendimin e Dytë të Apelit mbi Paraburgimin e *Thaçit*, para. 20.

<sup>72</sup> Vendimi i Apeluar, para. 27. Shih gjithashtu Apelin, para. 43.

<sup>73</sup> Shih Vendimin e Dytë të Apelit mbi Paraburgimin, para. 17 (theksimi është shtuar). Shih gjithashtu Vendimin e Apelit në lidhje me Lirimin në Çështjen 18-01, para. 18.

<sup>74</sup> Vendimi i Apeluar, para. 24.

<sup>75</sup> Vendimi i Apeluar, para. 27. Paneli rikujton se edhe gjykata të tjera kanë marrë parasysh se fakti që akuzat u konfirmuan do të rriste rrezikun e arratisjes. Shih p.sh., ICC, *Prosecutor v. Lubanga*, ICC-01/04-01/06-826, Review of the "Decision on the Application for the Interim Release of Thomas Lubanga Dyilo", 14 February 2007, p. 6.

33. Sipas Panelit, fakti që Gjykatësja e Procedurës Paraprake e përsëriti këtë konstatim në lidhje me arsye të tjera, nuk tregon se ajo nuk zbatoi prezumimin në favor të lirimit para gjykimit.<sup>76</sup> Bazuar në sa më lart, Paneli është bindur se Gjykatësja e Procedurës Paraprake zbatoi standardin e duhur në përputhje me praktikën e GJEDNJ-së.<sup>77</sup>

34. Kilaj nuk paraqet argumente të tjera konkrete përveç atyre të trajtuara më lart në mbështetje të pretendimit se Gjykatësja e Procedurës Paraprake iu referua konstatimeve të bëra në vendime të mëhershme, pa kryer një "analizë të duhur".<sup>78</sup> Sa i përket aktgjykimit të GJEDNJ-së në të cilin u mbështet Kilaj, Paneli vëren se në kontekstin e Aktgjykimit në çështjen *Vadim Melnik k. Ukrainës*, GJEDNJ-ja konstatoi se praktika që konsiston në përdorimin e një modeli standard për vazhdimin e paraburgimit para gjykimit, shkelte nenin 5 të GJEDNJ-së.<sup>79</sup> Konkretisht, GJEDNJ-ja theksoi se gjykatat vendore dhe gjykata e apelit e shtetit "u kufizuan në përsëritjen e një numri arsyesh për paraburgimin në një mënyrë abstrakte dhe stereotipe, pa dhënë elemente faktike dhe arsye pse gjykuan se ato pika ishin ende relevante për rastin e parashtruesit".<sup>80</sup> Paneli konstaton se Kilaj nuk demonstroi se kjo çështje e GJEDNJ-së dhe çështja aktuale, pasqyrojnë rrethana analoge dhe nuk do ta trajtojë më tej këtë argument.

35. Në lidhje me argumentin se Gjykatësja e Procedurës Paraprake nuk bëri konstatime konkrete të bazuara në prova,<sup>81</sup> Paneli vëren se Kilaj kundërshton përmendjen prej Gjykatësës së Procedurës Paraprake të peshës së veprave penale,

---

<sup>76</sup> Shih Vendimin e Apeluar, para. 30, 34. Shih Apelin, para. 41, 43.

<sup>77</sup> Shih p.sh. ECtHR, *Merabishvili v. Georgia*, no. 72508/13, Judgment, 28 November 2017, para. 222 (ku konstatohet se arsyetimi duhet të bazohet në rreziqe konkrete të faktuara).

<sup>78</sup> Shih Apelin, para. 48-50. Shih më lart, para. 29-31.

<sup>79</sup> Shih Apelin, para. 49, që i referohet paragrafit 111 të Aktgjykimit të 15 shtatorit 2022 në çështjen e GJEDNJ-së *Vadim Melnik k. Ukrainës*, nr. 62209/17 dhe 50933/18 ("*Aktgjykimi në Çështjen Vadim Melnik k. Ukrainës*"). Paneli vëren se ky aktgjykim u shpall më 15 shtator 2022, dhe jo më 15 shtator 2023 sikurse thuhet në Apel.

<sup>80</sup> *Aktgjykimi në Çështjen Vadim Melnik k. Ukrainës*, para. 111.

<sup>81</sup> Shih Apelin, para. 1, 51-58.

ashpërsisë së dënimit të mundshëm dhe faktit se Kilaj aktualisht ka njohuri për provat që do të paraqesë ZPS-ja.<sup>82</sup> Në kundërshtim me pretendimin e Kilajt, Paneli nuk sheh asnjë gabim në vendimin e Gjykatësës së Procedurës Paraprake për t'i marrë parasysh këta faktorë në mbështetje të vlerësimit të saj se rreziku i arratisjes vazhdon të ekzistojë.

36. Paneli thekson se pyetja që ngre neni 41(6)(b) i Ligjit është se a paraqiti ZPS-ja *arsyetim konkret të bazuar në prova* në mbështetje të idesë së një mundësie mjaftueshmërisht reale të ekzistencës së (një ose më shumë) rreziqeve sipas nenit 41(6)(b)(i)-(iii) të Ligjit.<sup>83</sup> Kjo megjithatë nuk do të thotë, siç sugjerohet nga Kilaj, se Gjykatësja e Procedurës Paraprake duhej të shtjellonte "provat mbi bazën e të cilave u bënë këto konstatime" ose "kuadrin faktik që mbështet akuzat me të cilat përballet aktualisht z. Kilaj".<sup>84</sup> Në lidhje me këtë, Paneli rikujton se cilësia dhe fuqia e provave të ZPS-së janë aspekte që diskutohen në gjykim dhe se vendimi aktual në lidhje me paraburgimin nuk është vendi i përshtatshëm/forumi i duhur për trajtimin e këtij argumenti.<sup>85</sup> As nga Gjykatësja e Procedurës Paraprake dhe as nga Paneli i Gjykatës

---

<sup>82</sup> Shih Apelin, para. 47.

<sup>83</sup> Shih Vendimin e Apelit në lidhje me Vazhdimin e Paraburgimit, para. 39 (theksimi është shtuar); KSC-BC-2020-06, IA007/F00005/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Rexhep Selimit kundër Vendimit për Rishikimin e Paraburgimit, 1 tetor 2021 (versioni konfidencial u dorëzua më 1 tetor 2021), para. 21 (theksimi në origjinal); KSC-BC-2020-06, IA033/F00006, Vendim mbi Apelin e Rexhep Selimit kundër Vendimit Përmbledhës në lidhje me Kërkesën për Lirim të Përkohshëm dhe mbi Rishikimin e Paraburgimit, 13 gusht 2025 (Vendimi i Pestë i Apelit mbi Paraburgimin e *Selimit*"), para. 28. Shih gjithashtu KSC-CC-PR-2017-01, F00004, Aktvendim mbi Referimin e Rregullores së Procedurës dhe të Provave miratuar nga Plenarja më 17 mars 2017, Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese sipas nenit 19(5) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, 26 prill 2017, para. 115 (ku Dhoma e Gjykatës Kushtetuese theksoi rëndësinë e arsytimit konkret dhe të arsyeve konkrete në të cilat duhet të mbështetet çdo panel në vendimet e veta për miratimin e paraburgimit për një periudhë të zgjatur kohe).

<sup>84</sup> Shih Apelin, para. 47.

<sup>85</sup> Vendimi i Apelit në lidhje me Vazhdimin e Paraburgimit, para. 41. Shih gjithashtu Vendimin e Dytë të Apelit mbi Paraburgimin e *Thaçit*, para. 40; Vendimin e Dytë të Apelit mbi Paraburgimin e *Veselit*, para. 23.

së Apelit nuk mund të pritet të shqyrtojnë themelësinë e akuzave dhe të gjitha provat e paraqitura nga ZPS-ja në përgatitje të gjykimit.<sup>86</sup>

37. Si argument vijues, me sa kupton Paneli, Kilaj me këtë nënkupton se Gjykatësja e Procedurës Paraprake duhej të kishte shpjeguar pse akuzat për mosbindje ndaj gjykatës me të cilat ai përballet janë veçanërisht të rënda krahasuar me "vepra penale të tjera të gjykueshme".<sup>87</sup> Në kontekstin e një çështjeje gjyqësore të mëparshme që përfshinte vepra penale kundër administrimit të drejtësisë, Dhoma e Gjykatës së Apelit theksoi se, ndonëse interesi publik për të mbrojtur integritetin e procedurave përmes ndjekjes efektive të veprave penale kundër administrimit të drejtësisë nuk duhet nënvlerësuar, vepra të tilla penale nuk janë aq të rënda sa krimet thelbësore të parapara në nenet 13 dhe 14 të Ligjit.<sup>88</sup> Megjithatë, Kilaj nuk jep ndonjë arsye se pse Gjykatësja e Procedurës Paraprake duhej të kishte krahasuar peshën e veprave penale për të cilat janë ngritur akuza para Dhomave të Specializuara në përgjithësi.<sup>89</sup> Paneli konstaton se Gjykatësja e Procedurës Paraprake nuk kreu asnjë gabim që iu referua "peshës së veprave penale për të cilat akuzohet [Kilaj]"<sup>90</sup> dhe që në këtë rast u përqendrua me të drejtë në peshën e akuzave.

<sup>86</sup> Shih p.sh., Vendimin e Dytë të Apelit mbi Paraburgimin e *Veselit*, para. 23; KSC-BC-2020-07, IA007/F00004 dhe IA008/F00004, Vendim Përmbledhës mbi Apelin e Nasim Haradinajt kundër Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit, 6 prill 2022 ("Vendimi i Përmbledhës i Apelit mbi Paraburgimin e *Haradinajt*"), para. 31.

<sup>87</sup> Shih Apelin, para. 47.

<sup>88</sup> Shih Vendimin e Apelit *Gucati*, para. 71.

<sup>89</sup> Paneli gjithashtu thekson se Kilaj i referohet jurisprudencës së Gjykatës Penale Ndërkombëtare ("GJPN") në mbështetje të argumentit të vet se GJPN-ja, në rrethana analoge, ka konsideruar se përgjegjësia e një të akuzuari për akuzat për mosbindje ndaj gjykatës, dhe "jo për ndonjë prej krimeve sipas nenit 5 të Statutit", peshonte në favor të kërkesës së tij për lirim të përkohshëm. Shih Apelin, para. 47, poshtëshënimin 50, që i referohet çështjes ICC, *Prosecutor v. Gicheru*, ICC-01/09-01/20-90-Red2, Public Redacted Version of 'Decision on Mr Gicheru's Request for Interim Release', 29 January 2021, ICC-01/09-01/20-90-Conf, 29 January 2021 ("*Gicheru* Decision on Detention"), para. 44. Megjithatë, Paneli thekson se, në kundërshtim me pretendimin e Kilajt, situata e tij nuk është e ngjashme me atë të Gikerut. Në lidhje me këtë, Paneli rikujton se në Vendimin mbi Paraburgimin e *Gikerut*, Dhoma e Procedurës Paraprake konstatoi se fakti që Gikeru akuzohej për mosbindje ndaj gjykatës "peshon[te] në favor të kërkesës [së tij] për lirim të përkohshëm "në rrethanat specifike të rastit të tij, konkretisht të një personi që ishte dorëzuar vullnetarisht dhe moskundërshtimit prej Prokurorit të kërkesës së tij për lirim të përkohshëm". Shih Vendimin mbi Paraburgimin e *Gikerusë*, para. 44 (theksimi është shtuar).

<sup>90</sup> Vendimi i Apeluar para. 25.

38. Si rezultat, Paneli i Gjykatës së Apelit konstaton se Kilaj nuk ka treguar se Gjykatësja e Procedurës Paraprake gaboi në zbatimin e standardit në shqyrtimin e vazhdimit të paraburgimit të Kilajt. Rrjedhimisht, rrëzohet pika e parë e Apelit të Kilajt.

B. PRETENDIMI PËR GABIM NË VLERËSIMIN E RELEVANCËS SË KOHËZGJATJES SË DËNIMIT QË MUND TË JEPET (PIKA 2)

### 1. Parashtrimet e palëve

39. Duke kujtuar se çdo arsyetim për paraburgimin kërkon një vlerësim të bazuar në fakte konkrete,<sup>91</sup> Kilaj argumenton se Gjykatësja e Procedurës Paraprake gaboi që, në kontekstin e vlerësimit të arsyeshmërisë së përgjithshme të vazhdimit të paraburgimit sipas rregullës 56(2) të Rregullores, hodhi poshtë si "spekulative dhe të pavenda" argumentet e tij në lidhje me mundësinë që paraburgimi i tij të zgjaste më shumë se çdo dënim i mundshëm.<sup>92</sup>

40. Kilaj argumenton se ekziston një "marrëdhënie e qartë midis dënimit të përgjithshëm të mundshëm dhe arsytimit për paraburgimin, përmes të cilës duhet të vlerësohet arsyeshmëria dhe proporcionaliteti i paraburgimit".<sup>93</sup> Sipas Kilajt, "kur periodha e paraburgimit zgjat më shumë se dënimi më i lartë i përcaktuar me ligj që mund të jepet, konstatimet e bazuara në të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut e bëjnë të qartë se i akuzuari duhet të lirohet".<sup>94</sup>

41. Kilaj parashtron se, deri në datën e parashtrimit të Apelit, ai ka kaluar 392 ditë në paraburgim.<sup>95</sup> Duke pasur parasysh kohëzgjatjen e paraburgimit të tij deri më tani dhe se dënimi më i lartë që ai mund të marrë është jo më shumë se pesë vjet burgim

---

<sup>91</sup> Apeli, para 54, që i referohet ECtHR, *Buzadji v. The Republic of Moldova*, no. 23755/07, Judgment, 5 July 2016 ("Aktgjykimi Buzadji"), para. 90.

<sup>92</sup> Apeli, para. 51-56.

<sup>93</sup> Apeli, para. 54. Shih gjithashtu Kundërpërgjigjen, para. 11-12.

<sup>94</sup> Apeli, para. 53, që i referohet Komisionit për të Drejtat e Njeriut, CCPR/C/GC/35, para. 38. Shih gjithashtu Apelin, para. 52; Kundërpërgjigjen, para. 11-12.

<sup>95</sup> Apeli, para. 55. Shih gjithashtu Apelin, para. 22.

për Pikën 15, Gjykatësja e Procedurës Paraprake e kishte për detyrë të shqyrtonte faktet dhe dënimin e mundshëm.<sup>96</sup>

42. Kilaj gjithashtu argumenton se Gjykatësja e Procedurës Paraprake përdori standarde të dyfishta pasi ajo, nga njëra anë, në vlerësimin e saj për rrezikun e arratisjes bëri konstatimin mbi kohëzgjatjen e mundshme të dënimit, por, nga ana tjetër, refuzoi të bënte të njëjtën gjë në vlerësimin e arsyeshmërisë së kohëzgjatjes së paraburgimit.<sup>97</sup> Kilaj parashtron se një "trajtim i tillë i padrejtë dhe i diferencuar i fakteve" është kritikuar nga GJEDNJ-ja.<sup>98</sup>

43. ZPS-ja përgjigjet se Kilaj keqinterpretonte Vendimin e Apeluar dhe se Gjykatësja e Procedurës Paraprake mbajti parasysh si duhet kohën shtesë të kaluar në paraburgim nga Kilaj që nga Vendimi i Dytë i Rishikimit.<sup>99</sup> ZPS-ja shton se një qasje e tillë është konfirmuar prej Dhomës së Gjykatës së Apelit duke pasur parasysh rishikimin e rregullt të domosdoshmërisë së vazhdimin të paraburgimit.<sup>100</sup>

44. Gjithashtu, ZPS-ja argumenton se Kilaj shpërfill faktin se proporcionaliteti i paraburgimit nuk vlerësohet në raport me kohëzgjatjen e pritshme të tij por në raport me rreziqet e përcaktuara në nenin 41(6)(b) të Ligjit së bashku me faktorë të tjerë, dhe se, në këtë kontekst, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstatoi me të drejtë se vlerësimi i proporcionalitetit mund të bazohet vetëm në rrethanat në kohën rishikimit, dhe jo në atë që mund të ndodhë ose jo në një të ardhme të parashikueshme.<sup>101</sup>

45. ZPS-ja parashtron se asnjë prej burimeve ligjore që citon Kilaj nuk mbështet qëndrimin e tij dhe gjithashtu rikujton se Kilaj ka kaluar afërsisht trembëdhjetë muaj

---

<sup>96</sup> Apeli, para. 55.

<sup>97</sup> Apeli, para. 57.

<sup>98</sup> Apeli, para. 58, që i referohet Aktgjykimit *Buzadji*, para. 112.

<sup>99</sup> Përgjigjja, para. 15. Shih gjithashtu Përgjigjen, para. 18.

<sup>100</sup> Përgjigjja, para. 15.

<sup>101</sup> Përgjigjja, para. 16.

në paraburgim, ndërkohë që mund të marrë një dënim të mundshëm me deri në pesë vjet dhe gjashtë muaj burgim.<sup>102</sup>

## 2. Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

46. Fillimisht, Paneli i Apelit rikujton se një panel ka detyrimin e përgjithshëm për të garantuar që periudha e mbajtjes në paraburgim të jetë e arsyeshme, në përputhje me nenin 29(2) të Kushtetutës dhe nenin 5(3) të KEDNJ-së.<sup>103</sup>

47. Paneli gjithashtu rikujton se rregulla 56(2) e Rregullores trajton konceptin e proporcionalitetit dhe "ndalon mbajtjen në paraburgim 'për një periudhë të paarsyeshme para hapjes së çështjes'".<sup>104</sup> Kohëzgjatja e paraburgimit në pritje të gjykimit është faktor që duhet marrë parasysh, së bashku me rreziqet e përshkruara në nenin 41(6)(b) të Ligjit, për të vlerësuar nëse, duke marrë parasysh të gjithë faktorët, vazhdimi i paraburgimit "pushon së qeni i arsyeshëm" dhe personi duhet të lirohet.<sup>105</sup> Panelet duhet të zbatojnë standardin e proporcionalitetit kur kryejnë rishikimin e arsyeshmërisë së paraburgimit të një personi. Konkretisht, panelet duhet të shqyrtojnë nëse mbajtja në paraburgim e personit është absolutisht e domosdoshme për të zvogëluar rreziqet sipas nenit 41(6)(b) të Ligjit apo nëse për këtë qëllim mund të jenë të mjaftueshme masa të tjera më pak të rrepta.<sup>106</sup> Paneli gjithashtu rikujton se ZPS-ja

<sup>102</sup> Përgjigjja, para. 17.

<sup>103</sup> Shih KSC-CC-PR-2020-09, F00006, Aktvendim mbi Referimin e Ndryshimeve të Rregullores së Procedurës dhe të Provave të Miratuar nga Plenarja më 29 dhe 30 Prill 2020, 26 maj 2020, para. 63. Shih gjithashtu Vendimin e Katërt të Apelit mbi Paraburgimin e *Veselit*, para. 103.

<sup>104</sup> Shih KSC-BC-2020-04, IA001/F00005/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Pjetër Shalës kundër Vendimit lidhur me Lirimin e Përkohshëm, 20 gusht 2021 (versioni konfidencial u dorëzua më 20 gusht 2021) (Vendimi i Parë i Apelit mbi Paraburgimin e *Shalës*), para. 48.

<sup>105</sup> Shih p.sh., KSC-BC-2020-06, IA003/F00005/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Rexhep Selimit kundër Vendimit lidhur me Lirimin e Përkohshëm, 30 prill 2021 (versioni konfidencial u dorëzua më 30 prill 2021) ("Vendimi i Parë i Apelit mbi Paraburgimin e *Selimit*"), para. 79 dhe jurisprudencën e cituar në të; KSC-BC-2020-06, IA014/F00008/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Kadri Veselit kundër Vendimit lidhur me Rishikimin e Vendimit të Kthyer mbi Paraburgimin dhe Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit, 31 mars 2022 (versioni konfidencial u dorëzua më 31 mars 2022), para. 61

<sup>106</sup> Vendimi i Apelit në lidhje me Lirimin në Çështjen 18-01, para. 18. Shih gjithashtu Vendimin e Katërt të Apelit mbi Paraburgimin e *Veselit*, para. 104; Vendimin e Apelit *Gucati*, para. 72.

ka detyrimin për të vërtetuar se mbajtja në paraburgim është e domosdoshme dhe se kohëzgjatja e paraburgimit vazhdon të jetë e arsyeshme.<sup>107</sup>

48. Paneli vëren se Gjykatësja e Procedurës Paraprake, për të arritur në përfundimin se periudha që Kilaj ka kaluar në paraburgim deri më tani nuk është e paarsyeshme, mori parasysh faktorët e mëposhtëm: (i) Kilaj është mbajtur në paraburgim nga 2 nëntori 2023 deri më 15 maj 2024, dhe pastaj që nga arrestimi i tij më 5 dhjetor 2024; (ii) Kilaj akuzohet për veprat penale të pengimit të procedurave dhe mosbindjes ndaj gjykatës, për të cilat, përkatësisht, mund të jepet dënimi me deri në pesë vjet e gjashtë muaj burgim; (iii) rreziqet sipas nenit 41(6)(b) të Ligjit nuk mund të zvogëlohen me masa më pak kufizuese sesa paraburgimi; dhe (iv) që nga Vendimi i Dytë i Rishikimit procesi po vijon me ritëm të shpejtë, çka bën që çështja të jetë "një hap më afër" kalimit të saj Trupit Gjykues.<sup>108</sup>

49. Paneli rikujton se lloji i veprës penale si dhe ashpërsia e dënimit janë faktorë të rëndësishëm për t'u marrë parasysh kur vendoset nëse paraburgimi është i nevojshëm në rrethanat e një çështjeje specifike.<sup>109</sup> Paneli gjithashtu pajtohet me Kilajn se arsyeshmëria e vazhdimit të paraburgimit të një të akuzuari nuk mund të vlerësohet teorikisht, por duhet të vlerësohet mbi bazën e fakteve të secilës çështjeje gjyqësore dhe sipas veçorive të saj specifike.<sup>110</sup> Në lidhje me këtë, Paneli vëren se Gjykatësja e Procedurës Paraprake përmendi shprehimisht dënimin më të lartë që Kilaj mund të marrë në këtë çështje gjyqësore, në qoftë se shpallet fajtor.<sup>111</sup> Sidoqoftë, në kundërshtim me çka parashtron Kilaj,<sup>112</sup> Paneli i Apelit gjykon se panelit të shkallës më të ulët nuk i kërkohet të trajtojë dënimin "*e mundshëm*" që mund t'i jepet një të

---

<sup>107</sup> Vendimi i Apelit në lidhje me Lirimimin në Çështjen 18-01, para. 18. Shih gjithashtu Vendimin e Apelit *Gucati*, para. 72 -73.

<sup>108</sup> Shih Vendimin e Apeluar, para. 41-42, 46.

<sup>109</sup> Vendimi i Apelit *Gucati*, para. 72.

<sup>110</sup> Shih Apelin, para. 54. Shih p.sh. Vendimin e Katërt të Apelit mbi Paraburgimin e *Veselit*, para. 104; Aktgjykimin *Buzadji*, para.90.

<sup>111</sup> Shih Vendimin e Apeluar, para. 41.

<sup>112</sup> Shih Apelin, para. 54. Shih gjithashtu Kundërpërgjigjen, para. 11-12.

akuzuari, pasi aspektet që lidhen me faktorët e mundshëm në rast të shpalljes fajtor dhe dënimit, nuk duhet të jenë pjesë e vendimit në lidhje me lirimin e përkohshëm.<sup>113</sup>

Paneli gjithashtu pajtohet me Gjykatësen e Procedurës Paraprake se vlerësimi i proporcionalitetit duhet të bazohet vetëm në rrethanat në kohën e rishikimit.<sup>114</sup>

50. Në lidhje me argumentin e Kilajt se koha që ai ka kaluar në paraburgim ka të ngjarë të jetë më e gjatë se dënimi që ai do të merrte, në qoftë se shpallej fajtor, Paneli gjithashtu vëren se, siç e pranon dhe Kilaj,<sup>115</sup> koha që ai ka kaluar në paraburgim deri më tani nuk është më e gjatë se dënimi më i lartë i mundshëm për disa prej veprave penale për të cilat akuzohet.<sup>116</sup> Rrjedhimisht, rasti i tij dallon nga situata kur një i

---

<sup>113</sup> Shih ICC, *Prosecutor v. Gbagbo and Blé Goudé*, ICC-02/11-01/15-992-Red, Judgment on the appeal of Mr Laurent Gbagbo against the decision of Trial Chamber I of 10 March 2017 entitled "Decision on Mr Gbagbo's Detention", 19 July 2017 ("Vendimi i Apelit *Gbagbo*"), para. 69 (ku Dhoma e Apelit e GJPN-së konstatoi se Dhomës Gjyqësore nuk i kërkohej të vlerësonte tashmë dënimin konkret që mund t'i jepej z. Gbagbo, pasi "dënimi konkret përcaktohet vetëm në fund të gjykimit, në qoftë se dhe kur personi shpallet fajtor për një krim") (theksimi është shtuar). Gjithashtu, Paneli vëren se Kilaj nuk sjell asnjë fakt në mbështetje të pretendimit të vet se ajo çka duhet marrë parasysh është dënimi "i mundshëm", dhe gjithashtu vëren se kjo qasje nuk gjen mbështetje në jurisprudencën përkatëse ndërkombëtare. Shih p.sh. ECtHR, *Panchenko v. Russia*, no. 45100/98, Judgment, 8 February 2005, para. 101 (ku përmendet "ashpërsia e dënimit që mund të jepet"; ECtHR, *Becciev v. Moldova*, no. 9190/03, Judgment, 4 October 2005, para. 58 (ku përmendet "ashpërsia e dënimit që rrezikohet të jepet"; ECtHR, *Ilijkov v. Bulgaria*, no. 33977/96, Judgment, 26 July 2001 ("*Ilijkov v. Bulgaria* Judgment"), paras 80-81 (ku përmendet "ashpërsia e dënimit që mund të jepet" dhe konstatohet se "nuk kishte kontroll gjyqësor lidhur me nëse provat mbështesnin dyshimin e arsyeshëm se i akuzuari kishte kryer veprën penale, për të cilën parashikohej një dënim i konsiderueshëm"); Vendimin e Apelit *Gbagbo*, para. 69 (ku Dhoma e Apelit e GJPN-së konstatoi se përmendja në kuadër të vendimit lidhur me lirimin e përkohshëm e peshës së veprave penale për të cilat u ngritën akuzat, përfshinte një vlerësim të bazuar në akuzat konkrete në një çështje, konkretisht, në qoftë se akuzat e ngritura ndaj personit të paraburgosur janë të rënda, ato mund të rezultojnë në një dënim me burgim të gjatë në rast të shpalljes fajtor); ICC, *Prosecutor v. Said Abdel Kani*, ICC-01/14-01/21-318, Judgment on the appeal of Mr Mahamat Said Abdel Kani against the decision of Trial Chamber VI entitled "Decision on the Defence Application for Interim Release of Mahamat Said Abdel Kani and Contact Restrictions", 19 May 2022, paras 46-47 (ku konstatohet se "akuzat në këtë çështje, në qoftë se provohen, sipas të gjitha gjasave do të rezultojnë në një dënim me burgim të gjatë); ICTY, *Prosecutor v. Čermak and Markač*, IT-03-73-AR65.1, Decision on Interlocutory Appeal Against Trial Chamber's Decision Denying Provisional Release, 2 December 2004, para. 25 (ku përmendet "ashpërsia e mundshme e dënimit"); ICTY, *Prosecutor v. Prlić et al.*, IT-04-74-AR65.1, AR65.2, AR65.3, Decision on Motions for Re-consideration, Clarification, Request for Release and Applications for Leave to Appeal, 8 September 2024, para. 30 (ku përmendet "pesha e krimeve për të cilat u ngritën akuzat dhe dënimi i gjatë i pritshëm, në qoftë se shpallet fajtor").

<sup>114</sup> Shih Vendimin e Apeluar, para. 43.

<sup>115</sup> Shih Apelin, para. 55.

<sup>116</sup> Shih Vendimin e Apeluar, para. 41; Aktakuzën e Konfirmuar të Ndryshuar, para. 48.

akuzuar do të duhej të lirohej për shkak se koha e kaluar prej tij në paraburgim para gjyqimit do të ishte më e gjatë se dënimi më i lartë që mund të jepej sipas ligjit.<sup>117</sup>

51. Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstatoi se Kilaj përsëriti argumente që në Vendimin e Dytë të Rishikimit ishin hedhur poshtë si "spekulative dhe të pavenda".<sup>118</sup> Paneli vëren se Kilaj kishte argumentuar para Gjykatësës së Procedurës Paraprake<sup>119</sup> se "ka të ngjarë që dënimi të jetë në skajin më të ulët të shkallëzimit prej një deri në pesë vjet burgim".<sup>120</sup>

52. Paneli i Apelit rikujton se cilësia dhe fuqia e pretenduar e provave të ZPS-së në këtë çështje, janë jorelevante për aspektin e vazhdimin të paraburgimit.<sup>121</sup> Si rezultat, Paneli konstaton se Gjykatësja e Procedurës Paraprake nuk ishte e detyruar të trajtonte nëse ishte e mundshme që dënimi që do t'i jepej Kilajt të ishte në skajin më të ulët të shkallëzimit të dënimit me burgim që mund t'i jepej, dhe nuk konstaton gabim në hedhjen poshtë si spekulativ të argumentit të Kilajt prej Gjykatësës së Procedurës Paraprake.

53. Paneli gjithashtu hedh poshtë argumentin e Kilajt se Gjykatësja e Procedurës Paraprake përdori standarde të dyfishta pasi ajo, nga njëra anë, në vlerësimin e saj për rrezikun e arratisjes bëri konstatimin mbi kohëzgjatjen e mundshme të dënimit, por, nga ana tjetër, refuzoi të bënte të njëjtën gjë në vlerësimin e arsyeshmërisë së kohëzgjatjes së paraburgimit.<sup>122</sup> Paneli vëren se në lidhje me rrezikun e arratisjes sipas nenit 41(6)(b) të Ligjit, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, mes faktorëve që mori

---

<sup>117</sup> Shih Apelin, para. 53.

<sup>118</sup> Vendimi i Apeluar, para. 43.

<sup>119</sup> Në kontekstin e Vendimit të Dytë të Rishikimit, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstatoi se "çdo mbështetje në plotësimin e kritereve prej z. Kilaj për ulje të dënimit të mundshëm në të ardhmen, nëse do të kishte, ishte tejet *spekulative*". Shih Vendimin e Dytë të Rishikimit, para. 43 (theksimi është shtuar).

<sup>120</sup> Shih Parashtrimet e Mbrojtjes para Gjykatësës së Procedurës Paraprake, para. 51. Shih gjithashtu Apelin, para, 55.

<sup>121</sup> Shih Vendimin e Apelit në lidhje me Vazhdimin e Paraburgimit, para. 41. Shih gjithashtu më lart, para. 36.

<sup>122</sup> Shih Apelin, para. 57.

parasysh, renditi mundësinë e një dënimi të lartë në rast të shpalljes fajtor.<sup>123</sup> Siç e pranon dhe Kilaj, ashpërsia e dënimit që mund të jepet është faktor relevant në vlerësimin e rreziqeve që e bëjnë paraburgimin të domosdoshëm.<sup>124</sup> Sipas Panelit, nuk ka kontradiktë apo standarde të dyfishta midis këtij konstatimi - bazuar në leximin e akuzave ndaj Kilajt - dhe refuzimit të Gjykatësës së Procedurës Paraprake për të trajtuar argumentet spekulative të Kilajt në lidhje me fuqinë hipotetike të provave të ZPS-së dhe dënimin e mundshëm që do t'i jepej Kilajt në qofte se shpallej fajtor.

54. Në lidhje me hedhjen poshtë prej Gjykatësës së Procedurës Paraprake të argumenteve të Kilajt si "të pavenda", Paneli vëren se Gjykatësja e Procedurës Paraprake e kishte bërë tashmë këtë konstatim konkret në Vendimin e Dytë të Rishikimit në lidhje me krahasimin që Kilaj ishte përpjekur të bënte me dënimet e dhëna në Çështjen KSC-BC-2023-10 ("Çështja 10") si rezultat i marrëveshjes për pranimin e fajësisë.<sup>125</sup> Kur në Vendimin e Apeluar Gjykatësja e Procedurës Paraprake hodhi poshtë argumentet e Kilajt, ajo konstatoi se Kilaj "përsëriti" argumente që ishin hedhur poshtë në Vendimin e Dytë të Rishikimit.<sup>126</sup> Sidoqoftë, Paneli vëren se nëse Kilaj përsëriti vërtet të njëjtin argument në Parashtrimet e Mbrojtjes para Gjykatësës së Procedurës Paraprake,<sup>127</sup> ai në fakt dha edhe argumente shtesë se pse sipas tij ky krahasim nuk ishte "i pavend".<sup>128</sup> Paneli vëren se Gjykatësja e Procedurës Paraprake

<sup>123</sup> Shih Vendimin e Apeluar, para. 25.

<sup>124</sup> Shih Aktgjykimin në çështjen *Ilijkovi k. Rumanisë*, para. 80. Shih Apelin, para. 52.

<sup>125</sup> Në kontekstin e Vendimit të Dytë të Rishikimit, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstatoi se "krahasimi që Kilaj [...]përpiqet të bëjë me dënimet e shqiptuara ndaj z. Sabit Januzi dhe z. Ismet Bahtijari si pjesë e marrëveshjeve të tyre për pranimin e fajësisë, [ishte] i pavend". Shih Vendimin e Dytë të Rishikimit, para. 43 (theksimi është shtuar). Shih gjithashtu F00208/RED, Version i Redaktuar Publik i Parashtrimeve të Kilajt në lidhje me Rishikimin e Paraburgimit, 11 mars 2025 (versioni konfidencial u dorëzua më 10 mars 2025) ("Parashtrimet e Rishikimit të Dytë"), para. 28.

<sup>126</sup> Shih Vendimin e Apeluar, para. 43, që i referohet Vendimit të Dytë të Rishikimit, para. 43.

<sup>127</sup> Krahaso Parashtrimet e Rishikimit të Dytë, para. 28 me Parashtrimet e Mbrojtjes para Gjykatësës së Procedurës Paraprake, para. 52.

<sup>128</sup> Shih Parashtrimet e Mbrojtjes para Gjykatësës së Procedurës Paraprake, para. 53-54. Kilaj argumentoi se ndonëse ai pranoi se të akuzuarit në Çështjen 10 ishin pranuar fajësinë dhe se "për rrjedhojë dënimet e tyre u zbutën në njëfarë mase", ata u dënuan për vepra penale që ishin "dukshëm më të rënda" se ato me të cilat përballet ai. Shih Parashtrimet e Mbrojtjes para Gjykatësës së Procedurës Paraprake, para. 53. Më konkretisht, Kilaj theksoi se Januzi dhe Bahtijari u dënuan secili me dy vjet burgim për "një

nuk i trajtoi shprehimisht këto argumente të reja. Sipas Panelit, ndonëse do të kishte qenë e preferueshme që Gjykatësja e Procedurës Paraprake të kishte dhënë një arsyetim më të detajuar se pse konstatoi se këto argumente vazhdonin të ishin të pavenda, Paneli nuk është bindur se Gjykatësja e Procedurës Paraprake nuk "u fut në analizën e problemeve" të ngritura në parashtrimet e Kilajt apo se ajo gaboi që konstatoi se këto argumente ishte të pavenda.<sup>129</sup>

55. Së fundi, në lidhje me argumentin e Kilajt se Gjykatësja e Procedurës Paraprake gaboi që "nuk mori parasysh kohën që ka kaluar",<sup>130</sup> Paneli i Apelit vëren se Gjykatësja e Procedurës Paraprake "mori parasysh si duhet" kohën shtesë që Kilaj kishte kaluar në paraburgim që nga Vendimi i Dytë i Rishikimit.<sup>131</sup> Paneli konstaton se Gjykatësja e Procedurës Paraprake, kur lëshoi Vendimin e Apeluar, mori parasysh shprehimisht kohën që ka kaluar dhe, rrjedhimisht, hedh poshtë argumentin e Kilajt.

56. Duke kujtuar se Gjykatësja e Procedurës Paraprake peshoi proporcionalitetin e paraburgimit të Kilajt kundrejt një numri faktorësh,<sup>132</sup> Paneli i Apelit është bindur se Gjykatësja e Procedurës Paraprake ka marrë parasysh si duhet kohëzgjatjen e periudhës së paraburgimit në pritje të gjykitimit kur gjykoi se në këtë fazë vazhdimi i paraburgimit të Kilajt mbetet proporcional.

57. Bazuar në sa më lart, Paneli konstaton se Kilaj nuk demonstroi se Gjykatësja e Procedurës Paraprake ka gabuar kur mori parasysh dënimin që mund të marrë Kilaj dhe kur konstatoi se koha e kaluar prej tij në paraburgim nuk është e paarsyeshme

---

paketë veprash penale më të rënda", konkretisht, frikësim sipas nenit 387 të KPK-së dhe pengim sipas nenit 401(2) dhe (5) të KPK-së, ku për frikësimin parashikohet një shkallëzim dënimi (dy deri në 10 vjet burgim) që është sa "dyfishi i atij të paraparë për pengimin". Shih Parashtrimet e Mbrojtjes para Gjykatësës së Procedurës Paraprake, para. 52-53.

<sup>129</sup> Shih Apelin, para. 56.

<sup>130</sup> Shih Apelin, para. 51.

<sup>131</sup> Shih Vendimin e Apeluar, para. 44.

<sup>132</sup> Shih Vendimin e Apeluar, para. 41-42, 44. Shih gjithashtu paragrafin 48 më lart. Gjykatësja e Procedurës Paraprake gjithashtu thekson se në bazë të nenit 41(10) të Ligjit dhe rregullës 57(2) të Rregullores, paraburgimi i Kilajt do të rishikohej rregullisht dhe në fund arriti në përfundimin se koha e kaluar prej tij në paraburgim ishte e arsyeshme brenda kuptimit të rregullës 56(2) të Rregullores. Shih Vendimin e Apeluar, para. 45-46.

brenda kuptimit të rregullës 56(2) të Rregullores.<sup>133</sup> Rrjedhimisht, rrëzohet pika e dytë e Apelit të Kilajt.

### C. PRETENDIMI PËR GABIME NË VLERËSIMIN E RREZIKUT TË PENGIMIT (PIKA 3)

#### 1. Parashtrimet e palëve

58. Kilaj argumenton se Gjykatësja e Procedurës Paraprake gaboi në vlerësimin prej saj të faktorëve relevantë për rrezikun e pengimit dhe në peshën që u dha atyre.<sup>134</sup>

59. Kilaj parashtron se Gjykatësja e Procedurës Paraprake gaboi që u mbështet në pretendimet se ai ndërhyri te dëshmitarët në çështjen *Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit dhe të tjerëve* KSC-BC-2020-06 ("Çështja 06"), edhe pse nuk ka prova që ai ta ketë bërë ndonjëherë këtë. Edhe po të kishte prova të tilla, Kilaj argumenton se, duke pasur parasysh konstatimin e vetë Gjykatësës së Procedurës Paraprake se aftësia për të rithirrur dëshmitarë është e "jashtëzakonshme", ajo nuk i dha peshën e duhur faktit se faza e paraqitjes së provave të ZPS-së në Çështjen 06 është mbyllur.<sup>135</sup> Duke u mbështetur në jurisprudencën e Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë ("TPNJ"), Kilaj argumenton se Gjykatësja e Procedurës Paraprake duhet të kishte pranuar se rreziku i pengimit të paktën është zvogëluar.<sup>136</sup> Gjithashtu, Kilaj argumenton se Gjykatësja e Procedurës Paraprake gaboi që u mbështet në atmosferën e frikës dhe frikësimit në Kosovë ndaj dëshmitarëve që dëshmojnë para Dhomave të Specializuara, si element që krijonte një rrezik "veçanërisht të lartë" që Kilaj të pengonte procesin.<sup>137</sup>

---

<sup>133</sup> Vendimi i Apeluar, para. 46.

<sup>134</sup> Apeli, para. 59. Shih gjithashtu Apelin, para. 61.

<sup>135</sup> Apeli, para. 62. Shih gjithashtu Kundërpërgjigjen, para. 13-14.

<sup>136</sup> Apeli, para. 63, që i referohet çështjes së ICTY, *Prosecutor v. Haradinaj et al.*, IT-04-84-T, Decision on Motion on Behalf of Ramush Haradinaj for Provisional Release, 14 December 2007 ("Vendimi në Çështjen *Haradinaj dhe të tjerët*"), para. 19. Shih gjithashtu Kundërpërgjigjen, para. 15. Paneli vëren se Kilaj gjithashtu argumenton se Gjykatësja e Procedurës Paraprake duhet të kryejë një vlerësim *de novo* të rrezikut të pengimit. Shih Kundërpërgjigjen, para. 15-16. Këto argumente janë trajtuar në kuadër të Pikës 1. Shih më lart, para. 29-31.

<sup>137</sup> Apeli, para. 64. Shih gjithashtu Kundërpërgjigjen, para. 17.

60. Kilaj gjithashtu parashtron se Gjykatësja e Procedurës Paraprake gaboi në konstatimin se ekziston rreziku që Kilaj të ndërhyjë te dëshmitarët në çështjen e tij.<sup>138</sup> Kilaj argumenton se ZPS-ja ende nuk e ka paraqitur listën e dëshmitarëve të saj dhe në kundërshtim me konstatimin e Gjykatësës së Procedurës Paraprake, ai nuk ka njohuri për identitetin e dëshmitarëve të mundshëm kundër tij, përveç njërit. Kilaj pretendon se do të ishte "absurde" të gjykohej se ky person mund të ndikohej prej tij dhe shton se Gjykatësja e Procedurës Paraprake nuk shpjegoi se si kjo mund të ishte një rrezik real.<sup>139</sup>

61. Së fundi, Kilaj argumenton se konstatimi i Gjykatësës së Procedurës Paraprake se ai "demonstroi gatishmëri për të shkelur urdhrat e gjykatës dhe për të ndërhyrë në procese në të cilat nuk është palë", lidhet drejtpërdrejt me aspektin kryesor në këtë çështje, për të cilin ende nuk është marrë vendim. Kilaj pretendon se, rrjedhimisht, ky konstatim është tërësisht i papërligjur.<sup>140</sup>

62. ZPS-ja përgjigjet se Kilaj thjesht nuk pajtohet me përfundimet e arsyeshme të Gjykatësës së Procedurës Paraprake dhe nuk pranon akuzat e konfirmuara kundër tij.<sup>141</sup> Në lidhje me mbylljen e paraqitjes së provave të ZPS-së në Çështjen 06, ZPS-ja argumenton se mundësia e rithirrjes së dëshmitarëve u vlerësua si duhet në kontekstin e faktorëve të shumtë të marrë parasysh prej Gjykatësës së Procedurës Paraprake.<sup>142</sup> ZPS-ja nënvizon se Trupi Gjykues II pranoi rrezikun e vazhdueshëm të ndërhyrjes në lidhje me dëshmitarët e ZPS-së, por edhe në lidhje me dëshmitarët që do të thirren prej Mbrojtjes së Viktimave dhe dëshmitarët e mundshëm të Mbrojtjes.<sup>143</sup> Sipas ZPS-së, përpjekjet për pengim nuk kufizohen vetëm te dëshmitarët e prokurorisë, por

---

<sup>138</sup> Apeli, para. 65.

<sup>139</sup> Apeli, para. 65.

<sup>140</sup> Apeli, para. 66.

<sup>141</sup> Përgjigjja, para. 19. Shih gjithashtu Përgjigjen, para. 25.

<sup>142</sup> Përgjigjja, para. 20, 22.

<sup>143</sup> Përgjigjja, para. 21.

mund të shtrihen edhe te dëshmitarët e Mbrojtjes, ose mund të përfshijnë forma të tjera të manipulimit të provave që nuk lidhen me dëshmitarët.<sup>144</sup>

63. ZPS-ja gjithashtu argumenton se rrethanat në çështjen e TPNJ-së në të cilën mbështetet Kilaj, janë të ndryshme.<sup>145</sup> Lidhur me faktin se ZPS-ja nuk ka paraqitur ende listën e dëshmitarëve, ZPS-ja përgjigjet se rreziku i pengimit nuk varet nga kjo listë. Përkundrazi, siç përcaktohet nga Gjykatësja e Procedurës Paraprake, informacioni që merret në një vendim konfirmimi, materialet e nxjerra, ose nga njohuritë e vetë të akuzuarit për faktet dhe rrethanat përkatëse, mund të përbëjë bazën e përpjekjeve për pengim.<sup>146</sup> Lidhur me atmosferën e frikës dhe frikësimit në Kosovë, ZPS-ja argumenton se Dhoma e Gjykatës së Apelit e ka konfirmuar këtë fakt si "faktor të rëndësishëm kontekstual" dhe Gjykatësja e Procedurës Paraprake e ka marrë parasysh si duhet, në kontekstin e faktorëve të tjerë.<sup>147</sup>

64. Së fundi, ZPS-ja parashtron se "gatishmëria e pakundërshtueshme dhe e demonstruar" e Kilajt për t'u përfshirë në veprime penguese, është padyshim relevante dhe është marrë parasysh si duhet prej Gjykatësës së Procedurës Paraprake në lidhje me rrezikun e pengimit të procesit. Sipas ZPS-së, rëndësia e këtij faktori në kuadër të vlerësimit të rrezikut u konfirmua më tej prej Panelit të Gjykatës së Apelit.<sup>148</sup>

65. Në Kundërpërgjigje, Kilaj argumenton se nuk ka "asnjë provë ku mund të bazohet frika" se ai do të ndërhyjë te dëshmitarët që do të thirren prej Mbrojtjes së Viktimave ose te dëshmitarët e Mbrojtjes, ose se ai do të kishte "çfarëdolloj përfitimi nga kjo".<sup>149</sup> Gjithashtu, Kilaj kundërpërgjigjet se nuk ka prova mbi të cilat të arrihet në përfundimin se ai mund të përfshihet në forma të tjera të manipulimit të provave që

---

<sup>144</sup> Përgjigjja, para. 22.

<sup>145</sup> Përgjigjja, para. 21.

<sup>146</sup> Përgjigjja, para. 22.

<sup>147</sup> Përgjigjja, para. 23.

<sup>148</sup> Përgjigjja, para. 24.

<sup>149</sup> Kundërpërgjigjja, para. 17.

nuk lidhen me dëshmitarët, dhe se Gjykatësja e Procedurës Paraprake nuk bëri një konstatim të tillë.<sup>150</sup>

## 2. Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

66. Fillimisht, Paneli i Apelit rikujton standardin e zbatueshëm për të përcaktuar nëse ndonjë prej arsyeve sipas nenit 41(6)(b) të Ligjit për ligj vazhdimin e paraburgimit, konkretisht standardin "më i ulët se pashmangshmëria, por më i lartë se thjesht mundësia që rreziku të materializohet".<sup>151</sup> Paneli gjithashtu rikujton se neni 41(6)(b) i Ligjit nuk kërkon që paneli i shkallës më të ulët të bindet se rreziqet e përcaktuara në nënparagrafët (i) deri (iii) do të materializohen realisht në rast të miratimit të lirimit të përkohshëm, ose të bindet se ka shumë të ngjarë që ato të materializohen.<sup>152</sup>

67. Paneli gjithashtu rikujton se vlerësimi i kryer nga një gjykatës sipas nenit 41(6)(b) të Ligjit është vlerësim tërësor i rrethanave konkrete të çështjes për të përcaktuar nëse ZPS-ja paraqiti arsyetim konkret të bazuar mbi prova në mbështetje të besimit në një mundësi mjaftueshmërisht reale të ekzistencës së (një ose më shumë) rreziqeve sipas nenit 41(6)(b)(i)-(iii) të Ligjit.<sup>153</sup>

68. Paneli i Apelit vëren se, gjatë vlerësimit të rrezikut të pengimit të ecurisë së proceseve të Dhomave të Specializuara sipas nenit 41(6)(b)(ii) të Ligjit, Gjykatësja e Procedurës Paraprake mori parasysh, ndër të tjera: (i) "gatishmërinë e demonstruar" nga z. Kilaj për të shkelur urdhrat e gjykatës dhe për të ndërhyrë në procese në të cilat ai nuk është palë, duke "keqpërdorur qëllimisht informacionin në lidhje me

---

<sup>150</sup> Kundërpërgjigjja, para. 18.

<sup>151</sup> Shih p.sh. Vendimin e Parë të Apelit mbi Paraburgimin e *Veselit*, para. 17; Vendimin e Katërt të Apelit mbi Paraburgimin e *Veselit*, para. 31.

<sup>152</sup> Shih p.sh. Vendimin e Parë të Apelit mbi Paraburgimin e *Veselit* para. 19; Vendimin e Katërt të Apelit mbi Paraburgimin e *Veselit*, para. 31.

<sup>153</sup> Shih p.sh. Vendimin e Apelit në lidhje me Vazhdimin e Paraburgimit, para. 39; Vendimin e Parë të Apelit mbi Paraburgimin e *Veselit*, para. 19; Vendimin e Katërt të Apelit mbi Paraburgimin e *Veselit*, para. 41.

dëshmitarët [e Dhomave të Specializuara] dhe duke treguar mospërfillje të qëllimshme për rregullat e konfidencialitetit [të Dhomave të Specializuara]"; (ii) njohuritë e tij për akuzat e ngritura kundër tij dhe për provat që i mbështesin ato; (iii) qasjen që Kilaj do të ketë në informacione të ndjeshme në lidhje me dëshmitarët, pasi të marrë Aktakuzën e Konfirmuar; (iv) faktin se procesi në Çështjen 06 po vijon dhe Trupi Gjykses mund të dëgjojë dëshmi të mëtejshme nga viktimat pjesëmarrëse, dëshmitarët e Mbrojtjes dhe nga dëshmitarët që paraqesin kundërprova, përfshirë nga dëshmitarë që tashmë mund të kenë dëshmuar; (v) "njohuritë e mjaftueshme" të Kilajt për identitetin e dëshmitarëve të mundshëm në çështjen aktuale; (ii) faktin se rreziku i ndërhyrjes ka të bëjë edhe me dëshmitarë që kanë dëshmuar tashmë dhe të cilët mund të jenë objekt i hakmarrjes ose të nxiten të tërheqin dëshmitë e tyre, duke kërcënuar kështu integritetin e gjykimit aktual në Çështjen 06 dhe procedurat e ardhshme gjyqësore në këtë çështje; (vii) atmosferën e përgjithshme të frikës dhe frikësimit në Kosovë kundër dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të mundshëm të Dhomave të Specializuara; dhe (viii) profilin publik të Kilajt në Kosovë.<sup>154</sup>

69. Lidhur me marrjen parasysh prej Gjykatës së Procedurës Paraprake të "gatishmërisë së demonstruar" të Kilajt për të shkelur urdhrat e gjykatës dhe për të ndërhyrë në procese në të cilat ai nuk është palë,<sup>155</sup> Paneli vëren se Kilaj argumenton se nuk ka prova që ai të ketë ndërhyrë ndonjëherë te dëshmitarët në Çështjen 06,<sup>156</sup> se ky element "lidhet drejtpërdrejt me aspektin kryesor në këtë çështje, për të cilin ende nuk është marrë vendim"<sup>157</sup> dhe se sido që të ishte, Gjykatësja e Procedurës Paraprake nuk pranoi se rreziku i pengimit në lidhje me dëshmitarët në Çështjen 06 është zvogëluar pasi paraqitja e provave të ZPS-së është mbyllur.<sup>158</sup>

---

<sup>154</sup> Vendimi i Apeluar, para. 30, 32. Shih gjithashtu Vendimin e Apeluar, para. 26.

<sup>155</sup> Shih Vendimin e Apeluar, para. 30.

<sup>156</sup> Apeli, para. 62.

<sup>157</sup> Apeli, para. 66.

<sup>158</sup> Apeli, para. 62-63.

70. Paneli rikujton se standardi për vlerësimin e rreziqeve sipas nenit 41(6)(b) të Ligjit nuk kërkon që të demonstrohet se Kilaj *ka* frikësuar dëshmitarë ose ndërhyrë te ta, ose se ai *do* ta bëjë këtë. Paneli thekson se për përcaktimin e domosdoshmërisë së mbajtjes në paraburgim pyetja që ngrihet ka të bëjë me mundësinë, jo me pashmangshmërinë e një ngjarjeje në të ardhmen,<sup>159</sup> dhe se neni 41(6)(b) i Ligjit nuk kërkon që të vërtetohet se në të shkuarën pengimi ka ndodhur realisht.<sup>160</sup> Rrjedhimisht, sugjerimi i Kilajt se nuk ka prova se ai ka ndërhyrë ndonjëherë te dëshmitarët në Çështjen 06,<sup>161</sup> është jorelevant për këtë vendim.<sup>162</sup>

71. Lidhur me argumentin përkatës të Kilajt se konstatimi mbi "gatishmërinë e demonstruar" të tij për të shkelur urdhrat e gjykatës dhe për të ndërhyrë në procese në të cilat nuk është palë, është një element që "lidhet drejtpërdrejt me aspektin kryesor në këtë çështje, për të cilin ende nuk është marrë vendim",<sup>163</sup> Paneli së pari rikujton se lloji shumë specifik i akuzave të konfirmuara është faktor i rëndësishëm se Gjykatësja e Procedurës Paraprake e mori parasysh këtë në vlerësimin prej saj të ekzistencës së rrezikut të pengimit të procesit.<sup>164</sup> Edhe pse nuk ishte e gabuar që ajo të mbështetej në akuzat e konfirmuara në këtë çështje, Paneli është i mendimit se gjuha e përdorur prej Gjykatësës së Procedurës Paraprake, konkretisht se Kilaj "demonstroi gatishmëri për të [penguar procesin]",<sup>165</sup> mund të krijojë njëfarë paqartësie. Sidoqoftë, sipas Panelit, referenca e kontestuar e Gjykatësës së Procedurës Paraprake duhet kuptuar në kontekstin përkatës dhe nuk përbën konstatim në lidhje me akuzat e Aktakuzës, të cilat duhet të provohen jashtë dyshimit të arsyeshëm prej ZPS-së në gjykim.

<sup>159</sup> Shih Vendimin e Apelit *Gucati*, para. 67. Shih gjithashtu Vendimin e Parë të Apelit mbi Paraburgimin e *Veselit*, para. 19; Vendimin e Katërt të Apelit mbi Paraburgimin e *Veselit*, para. 36.

<sup>160</sup> Shih Vendimin e Parë të Apelit mbi Paraburgimin e *Veselit*, para. 38.

<sup>161</sup> Shih Apelin, para. 62.

<sup>162</sup> Vendimi i Apelit në lidhje me Vazhdimin e Paraburgimit, para. 43. Shih gjithashtu Vendimin Përmbledhës të Apelit mbi Paraburgimin e *Haradinajt*, para. 44.

<sup>163</sup> Shih Apelin, para. 66, që i referohet Vendimit të Apeluar, para. 25, poshtëshënimi 41.

<sup>164</sup> Vendimi Përmbledhës i Apelit mbi Paraburgimin e *Haradinajt*, para. 45.

<sup>165</sup> Shih Vendimin e Apeluar, para. 30.

72. Sidoqoftë, rishikimi i konstatimeve të tjera në Vendimin e Apeluar tregon se Gjykatësja e Procedurës Paraprake mbajti parasysh standardin e zbatueshëm dhe kriterin, sipas nenit 41(6)(a) të Ligjit, për të përcaktuar nëse në kohën e vendimit të rishikimit, vazhdon të ekzistojë "dyshimi i bazuar se [i akuzuari] ka kryer një vepër penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara".<sup>166</sup> Në lidhje me këtë, Paneli vëren se, diku tjetër në Vendimin e Apeluar, Gjykatësja e Procedurës Paraprake iu referua saktë "dyshimit të bazuar" se Kilaj kreu vepra penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara.<sup>167</sup> Rrjedhimisht, Paneli konstaton se ishte brenda diskrecionit të Gjykatës së Procedurës Paraprake që, në kuadër të rishikimit prej saj të paraburgimit, të mbështetej në këtë faktor, si një ndër të tjerë, për të arritur në përfundimin mbi ekzistencën e rrezikut të pengimit.

73. Lidhur me ndikimin e mbylljes së paraqitjes së provave prej ZPS-së në Çështjen 06,<sup>168</sup> Paneli së pari vëren se, në kundërshtim me pretendimin e Kilajt,<sup>169</sup> jurisprudenca e TPNJ-së në të cilën ai mbështetet nuk pasqyron rrethana të ngjashme me çështjen e tij<sup>170</sup> dhe deklarata e cituar prej Kilajt në Apel është nxjerrë në mënyrë çorientuese nga konteksti. Konkretisht, Paneli vëren se vendimi i TPNJ-së për miratimin e kërkesës së të akuzuarit, z. Brahimaj, për lirim të përkohshëm gjatë periudhës së pushimit të

---

<sup>166</sup> Shih Vendimin e Apeluar, para. 22. Shih gjithashtu Vendimin e Apelit në lidhje me Vazhdimin e Paraburgimit, para. 43 (ku Paneli theksoi se në Vendimin mbi Fletarrestimet, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstatoi se *pretendohej* që Kilaj kishte keqpërdorur qëllimisht "informacionin në lidhje me dëshmitarët [e Dhomave të Specializuara]" dhe *pretendoi* se ai kishte shfaqur "mospërfillje të qëllimshme për rregullat e konfidencialitetit [të Dhomave të Specializuara]") (theksimi është shtuar). Shih gjithashtu p.sh. Vendimin Përmbledhës të Apelit mbi Paraburgimin e *Haradinajt*, para. 28; Vendimin e Dytë të Apelit mbi Paraburgimin e *Thaçit*, para. 36.

<sup>167</sup> Shih p.sh. Vendimin e Apeluar, para. 23. Shih gjithashtu Vendimin e Apelit *Gucati*, para. 60 ("Paneli i Gjykatës së Apelit mendon se mënyra në të cilën Gjykatësi i Vetëm i referohet sjelljes së z. Guçati duhet të kuptohet në kuadrin e analizës së tij dhe të konstatimit të bërë në pajtim me nenin 41(6) të Ligjit se provat vërtetojnë "dyshimin e bazuar" se z. Guçati "ka kryer një vepër penale që është nën juridiksionin e Dhomave të Specializuara".

<sup>168</sup> Shih Apelin, para. 62, 63.

<sup>169</sup> Shih Apelin, para. 63, që i referohet Vendimit në Çështjen *Haradinaj dhe të tjerët*, para. 19.

<sup>170</sup> Nga shikimi i Vendimit të TPNJ-së në Çështjen *Haradinaj dhe të tjerët* kuptohet se i akuzuari, i cili i ishte dorëzuar vullnetarisht TPNJ-së, në fakt po kërkonte lirim të përkohshëm të shkurtër, gjatë periudhës së pushimit të gjykatës, dhe se ky mocion bazohej në arsye humanitare. Shih Vendimin në Çështjen *Haradinaj dhe të tjerët*, para. 1, 8, 10, 21.

gjykatës, u bazua kryesisht në faktin se paraqitja e provave prej prokurorisë në çështjen e *vet* të akuzuarit ishte mbyllur dhe se mbrojtja nuk do të paraqiste prova. Në këto rrethana, dhoma gjyqësore e TPNJ-së konstatoi se rreziku i ndërhyrjes të dëshmitarët, viktimat ose personat e tjerë ishte "zvogëluar edhe më".<sup>171</sup>

74. Sidoqoftë, Paneli i Apelit rikujton se, për vlerësimin e rrezikut të pengimit sipas nenit 41(6)(b)(ii) të Ligjit, nuk ka kufi kohor, dhe ajo që ka rëndësi është se a ekziston rreziku i pengimit të "ecurisë së procesit penal", jo vetëm i ecurisë së gjykimit.<sup>172</sup> Ndonëse Paneli i Apelit rikujton se rreziku i pengimit ka të ngjarë të zvogëlohet me kalimin e kohës,<sup>173</sup> në varësi të rrethanave të çështjes gjyqësore, ky rrezik mund të mos zvogëlohet gjithmonë ndjeshëm.<sup>174</sup> Paneli gjithashtu rikujton konstatimin e Dhomës së Gjykatës së Apelit në lidhje me një çështje gjyqësore tjetër në Dhomat e Specializuara, se rreziku i pengimit mund të vazhdojë deri në fund të gjykimit.<sup>175</sup>

75. Lidhur me nëse ekziston ende rreziku që ai të pengojë procesin në Çështjen 06, Kilaj argumenton se ndonëse mbyllja e paraqitjes së provave të ZPS-së në Çështjen 06 "mund të mos e ketë zhdukur plotësisht rrezikun e pengimit, [Gjykatësja e Procedurës Paraprake] duhet ta kishte pranuar se kjo domosdoshmërisht e zvogëlon atë".<sup>176</sup> Paneli

<sup>171</sup> Vendimi në Çështjen *Haradinaj dhe të tjerët*, para. 19.

<sup>172</sup> Vendimi i Katërt i Apelit mbi Paraburgimin e *Veselit*, para. 35. Shih gjithashtu Vendimin Përmbledhës të Apelit mbi Paraburgimin e *Haradinajt*, para. 41.

<sup>173</sup> Shih p.sh. Vendimin e Katërt të Apelit mbi Paraburgimin e *Veselit* para. 35; Shih gjithashtu Vendimin Përmbledhës të Apelit mbi Paraburgimin e *Haradinajt*, para. 42; ECtHR, *Letellier v. France*, no. 12369/86, Judgment, 26 June 1991, para. 39; ECtHR, *W. v. Switzerland* no. 14379/88, Judgment, 26 January 1993, para. 35; ECtHR, *Clooth v. Belgium*, no. 12718/87, Judgment, 12 December 1991, para. 43.

<sup>174</sup> Vendimi i Katërt i Apelit mbi Paraburgimin e *Veselit*, para. 35. Shih gjithashtu Vendimin Përmbledhës të Apelit mbi Paraburgimin e *Haradinajt*, para. 42.

<sup>175</sup> Vendimi Përmbledhës i Apelit mbi Paraburgimin e *Haradinajt*, para. 42-43. Veç kësaj, në Çështjen 06, Dhoma e Gjykatës së Apelit gjithashtu konfirmoi konstatimin e Trupit Gjyqësor se vazhdonte të ekzistonte rreziku i pengimit të procesit të Dhomave të Specializuara sipas nenit 41(6)(b)(ii) të Ligjit në lidhje me dëshmitarët e ZPS-së, pavarësisht përfundimit të paraqitjes së provave të ZPS-së. Shih Vendimin e Katërt të Apelit mbi Paraburgimin e *Veselit* para. 49; Vendimin e Pestë të Apelit mbi Paraburgimin e *Selimit*, para. 54; KSC-BC-2020-06, IA035/F00005/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Jakup Krasniqit kundër Vendimit Përmbledhës mbi Kërkesën për Lirim të Përkohshëm dhe mbi Rishikimin e Paraburgimit, 14 gusht 2025 (versioni konfidencial u dorëzua më 13 gusht 2025), para. 34.

<sup>176</sup> Shih Apelin, para. 63.

vëren se, në Vendimin e Apeluar, kur trajtoi argumentin e Kilajt në lidhje me këtë aspekt, konkretisht se mbyllja e paraqitjes së provave prej ZPS-së zhduku rreziqet e pengimit në Çështjen 06, Gjykatësja e Procedurës Paraprake vuri në dukje se ky rrezik "nuk pushon së ekzistuari me mbylljen e paraqitjes së provave të ZPS-së".<sup>177</sup>

76. Paneli rikujton se, për të përcaktuar nëse ekziston ndonjë prej arsyeve për paraburgim të përcaktuara në nenin 41(6)(b) të Ligjit, nuk kërkohet që paneli që kryen rishikimin e paraburgimit të "*përcaktojë nivelin*" e rrezikut të pengimit që evidenton, por duhet të bindet se "ka arsye të artikulueshme për të besuar" se të paktën një prej rreziqeve të renditura në nenin 41(6)(b) të Ligjit do të materializohet.<sup>178</sup>

77. Për këto arsye, Paneli konstaton se Gjykatësja e Procedurës Paraprake nuk ishte e detyruar të përcaktonte se a ishte zvogëluar rreziku i pengimit në lidhje me Çështjen 06, për sa kohë që ajo ishte e bindur se rreziku vazhdonte të ekzistonte në përputhje me këtë standard të zbatueshëm. Rrjedhimisht, argumenti i Kilajt hidhet poshtë.

78. Lidhur me pretendimin e Kilajt se Gjykatësja e Procedurës Paraprake gaboi që konstatoi se ekzistonte rreziku që ai të ndërhynte te dëshmitarët në çështjen e vet, Paneli vëren se Kilaj argumenton në veçanti se ZPS-ja ende nuk e ka dorëzuar listën e dëshmitarëve të saj dhe se ai nuk njih asnjë prej tyre, përveç njërit.<sup>179</sup> Sidoqoftë, Paneli rikujton se për përcaktimin e ekzistencës së rreziqeve sipas nenit 41(6)(b) të Ligjit nuk nevojitet një vlerësim individual i rreziqeve dhe/ose cenueshmërive konkrete për secilin dëshmitar të veçantë,<sup>180</sup> dhe fakti se një të akuzuari nuk i janë dhënë ende

---

<sup>177</sup> Vendimi i Apeluar, para. 31.

<sup>178</sup> Shih p.sh. Vendimin e Pestë të Apelit mbi Paraburgimin e *Selimit*, para. 48. Shih gjithashtu KSC-BC-2020-06, IA007/F00005/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Rexhep Selimit kundër Vendimit të Rishikimit të Paraburgimit, 1 tetor 2021 (versioni konfidencial u dorëzua më 1 tetor 2021), para. 19-23.

<sup>179</sup> Shih Apelin, para. 65.

<sup>180</sup> Shih Vendimin e Pestë të Apelit mbi Paraburgimin e *Selimit*, para. 27. Paneli mban parasysh argumentin përkatës të Kilajt se ai njih vetëm një dëshmitar të ZPS-së dhe se do të ishte "absurde" të konsiderohej se ky person mund të ndikohej prej tij. Shih Apelin, para. 65. Duke supozuar se argumenti i Kilajt është se Gjykatësja e Procedurës Paraprake duhet ta kishte vlerësuar rrezikun e ndërhyrjes në raport me këtë dëshmitar konkret, Paneli nuk është bindur se ajo e kishte për detyrim ta bënte këtë.

identitetet e dëshmitarëve të ZPS-së nuk e përjashton konstatimin se ekziston rreziku i pengimit të ecurisë së procesit të Dhomave të Specializuara sipas nenit 41(6)(b)(ii) të Ligjit.<sup>181</sup>

79. Paneli vëren se Kilaj kundërshton konstatimin e Gjykatës së Procedurës Paraprake se ai ka "njohuri të mjaftueshme" për identitetin e dëshmitarëve të mundshëm.<sup>182</sup> Duke supozuar se është vërtet e saktë se ZPS-ja nuk e ka dorëzuar ende listën e dëshmitarëve të saj,<sup>183</sup> Paneli vëren se Gjykatësja e Procedurës Paraprake mori parasysh edhe faktin se Kilaj ka njohuri për provat që mbështesin akuzat kundër tij dhe se që kur iu dorëzua Aktakuza e Konfirmuar, ai ka pasur qasje në informacione të ndjeshme në lidhje me dëshmitarët.<sup>184</sup> Në lidhje me këtë, Paneli gjithashtu vëren se Gjykatësja e Procedurës Paraprake mbajti parasysh edhe faktin se ZPS-ja kishte përfunduar "në pjesën më të madhe" nxjerrjen e provave të saj sipas rregullës 102(1) të Rregullores.<sup>185</sup> Si rezultat, Paneli nuk konstaton gabim në mbështetjen e Gjykatës së Procedurës Paraprake në njohuritë e Kilajt për çështjen për të arritur në përfundimin se ekzistonte rreziku që ai të ndërhynte te dëshmitarët në çështjen e tij.

80. Paneli mban parasysh se qasja e të akuzuarit në informacionin konfidencial në lidhje me dëshmitarët dhe njohuritë e shtuara të tij për të, në vetvete nuk mjafton për të përlligjur refuzimin e lirimit të përkohshëm,<sup>186</sup> ndonëse këto mund të jenë faktorë relevantë për të përcaktuar ekzistencën e rrezikut të pengimit,<sup>187</sup> dhe rrisin aftësinë për

---

Duke pasur parasysh se, sikurse u tha më lart, për përcaktimin e ekzistencës së rreziqeve sipas nenit 41(6)(b) të Ligjit nuk nevojitet një vlerësim individual i rreziqeve dhe/ose cenueshmërive konkrete për secilin dëshmitar të veçantë, argumenti i Kilajt hidhet poshtë.

<sup>181</sup> Shih Vendimin e Pestë të Apelit mbi Paraburgimin e *Selimit*, para. 27.

<sup>182</sup> Shih Vendimin e Apeluar, para. 31.

<sup>183</sup> Shih F00395, Urdhër në lidhje me Kalendarin për Pjesën e Mbetur të Procedurës Paraprake, 25 korrik 2025, para. 16, 18(c) (ku ZPS-ja urdhërohet të dorëzojë, ndër të tjera, listën e dëshmitarëve të saj deri më 19 shtator 2025). Shih gjithashtu Apelin, para. 65.

<sup>184</sup> Shih Vendimin e Apeluar, para. 30.

<sup>185</sup> Shih Vendimin e Apeluar, para. 30, 42, poshtëshënimin 70. Shih gjithashtu Vendimin e Apeluar, poshtëshënimin 41.

<sup>186</sup> Shih p.sh. Vendimin e Dytë të Apelit mbi Paraburgimin e *Thaçit*, para. 38; Vendimin e Dytë të Apelit mbi Paraburgimin e *Veselit*, para. 31.

<sup>187</sup> Shih Vendimin e Apelit në lidhje me Vazhdimin e Paraburgimit, para. 44.

të penguar procesin, pasi të akuzuarit i vihet në dispozicion informacion më i hollësishëm.<sup>188</sup> Megjithatë, në rrethanat aktuale dhe duke pasur parasysh faktorët e tjerë në të cilët është mbështetur Gjykatësja e Procedurës Paraprake, të konfirmuar në Apel,<sup>189</sup> Paneli i Apelit konstaton se ishte brenda diskrecionit të Gjykatësës së Procedurës Paraprake t'i konsideronte nxjerrjen në vazhdimësi të provave në këtë çështje dhe qasjen e shtuar të Kilajt në informacionin në lidhje me dëshmitarët si faktorë kontribuues në ekzistencën e rrezikut të ndërhyrjes ndaj dëshmitarëve në këtë çështje.

81. Së fundi, Paneli e konstaton të themeltë argumentin e Kilajt se Gjykatësja e Procedurës Paraprake nuk shtjelloi shprehimisht nëse ai mund të ndërhyjë te dëshmitarët e Mbrojtjes apo të përfshihet në forma të tjera të "manipulimit të provave që nuk lidhen me dëshmitarët".<sup>190</sup> Rrjedhimisht, Paneli nuk do të trajtojë argumentet e ZPS-së në lidhje me këtë aspekt.<sup>191</sup>

82. Lidhur me përmendjen prej Gjykatësës së Procedurës Paraprake të atmosferës së përgjithshme të frikësimit që vazhdon në Kosovë,<sup>192</sup> Paneli rikujton se, megjithëse ky është faktor kontekstual relevant që duhet të merret parasysh për të vlerësuar nëse ekzistojnë rreziqet e parashikuara në nenin 41(6)(b)(ii) të Ligjit, i vetëm, ai është i pamjaftueshëm për të përlligjur vazhdimin e paraburgimit.<sup>193</sup> Megjithatë, Paneli vë në dukje se Gjykatësja e Procedurës Paraprake e mori parasysh këtë faktor vetëm si faktor kontekstual të përgjithshëm.<sup>194</sup> Një lexim i thjeshtë i Vendimit të Kundërshtuar tregon se Gjykatësja e Procedurës Paraprake vlerësoi rrezikun e pengimit të ecurisë së procesit të Dhomave të Specializuara sipas nenit 41(6)(b)(ii) të Ligjit bazuar në faktorët

---

<sup>188</sup> Shih Vendimin e Dytë të Apelit mbi Paraburgimin e *Thaçit*, para. 40.

<sup>189</sup> Shih më lart para. 68, 72, 77.

<sup>190</sup> Shih Kundërpërgjigjen, para. 18.

<sup>191</sup> Shih Përgjigjen, para. 22.

<sup>192</sup> Shih Apelin, para. 64.

<sup>193</sup> Shih p.sh. Vendimin e Pestë të Apelit mbi Paraburgimin e *Selimit* para. 31; Vendimin e Parë të Apelit mbi Paraburgimin e *Selimit*, para. 61.

<sup>194</sup> Vendimi i Apeluar, para. 32.

e tjerë të përmendur më lart,<sup>195</sup> dhe theksoi qartë se i vlerësoi këta faktorë "në kontekst" të atmosferës së frikës dhe frikësimit në Kosovë kundër dëshmitarëve (të mundshëm) që japin dëshmi para Dhomave të Specializuara.<sup>196</sup> Rrjedhimisht, në kundërshtim me pretendimin e Kilajt, Gjykatësja e Procedurës Paraprake nuk u mbështet vetëm në këtë faktor për të arritur në përfundimin se rreziku që ai të pengojë procesin vazhdon të jetë veçanërisht i lartë.<sup>197</sup>

83. Gjithashtu, ndonëse Paneli pajtohet me Kilajn se Gjykatësja e Procedurës Paraprake nuk e "lidhi" këtë element me të personalisht,<sup>198</sup> Paneli gjykon se kjo nuk ishte e nevojshme dhe se ishte e arsyeshme që, gjatë vlerësimit prej saj të rrezikut që Kilaj të pengonte procesin e Dhomave të Specializuara, Gjykatësja e Procedurës Paraprake të mbante parasysh, si faktor kontekstual, atmosferën e ndërhyrjeve ndaj dëshmitarëve që mbizotëron në Kosovë.

84. Duke kujtuar kompetencën diskrecionale të panelit të shkallës më të ulët për të vlerësuar rrethanat që mbështesin ose janë kundër paraburgimit,<sup>199</sup> Paneli konstaton se ishte në diskrecionin e Gjykatësës së Procedurës Paraprake të gjykonte se vazhdonte të ekzistonte rreziku që Kilaj të pengonte procesin e Dhomave të Specializuara sipas nenit 41(6)(b)(ii) të Ligjit.<sup>200</sup> Rrjedhimisht, rrëzohet Pika e Tretë e Apelit të Kilajt.

#### D. PRETENDIMI PËR GABIME NË VLERËSIMIN E RREZIKUT TË ARRATISJES (PIKA 4)

##### 1. Parashtrimet e palëve

85. Kilaj argumenton se Gjykatësja e Procedurës Paraprake u mbështet në mënyrë të gabuar në nxjerrjen e vazhdueshme të materialit të ZPS-së për të mbështetur

---

<sup>195</sup> Shih më lart, para. 68.

<sup>196</sup> Apeli, para. 64.

<sup>197</sup> Vendimi i Apeluar, para. 32.

<sup>198</sup> Shih Apelin, para. 64.

<sup>199</sup> Shih p.sh. Vendimin e Apelit në lidhje me Lirimën në Çështjen 18-01, para. 15. Shih gjithashtu Vendimin e Apelit *Gucati*, para. 49.

<sup>200</sup> Vendimi i Apeluar, para. 33.

konstatimin e saj se Kilaj ka "më shumë njohuri për provat që mbështesin akuzat si rezultat i procesit të nxjerrjes në vazhdimësi të tyre".<sup>201</sup> Kilaj jep një listë shembujsh të materialeve të nxjerra që, sipas tij, tregojnë se Gjykatësja e Procedurës Paraprake u mbështet në një numër paketash të materialit të nxjerrë të cilat nuk përmbajnë asnjë provë, ose nuk përmbajnë asnjë provë domethënëse në lidhje me çështjen kundër Kilajt konkretisht.<sup>202</sup> Rrjedhimisht, Kilaj argumenton se asnjë prej materialeve në të cilat është mbështetur Gjykatësja e Procedurës Paraprake nuk i jep atij njohuri të mëtejshme mbi provat kundër tij dhe se logjikisht asnjë prej tyre nuk mund t'i kontribuojë përfundimit se ai paraqet rrezik arratisjeje.<sup>203</sup>

86. ZPS-ja përgjigjet se Kilaj shtrembëron Vendimin e Apeluar,<sup>204</sup> dhe se nxjerrja në vazhdimësi e materialit përkatës të ZPS-së, është faktor tërësisht relevant në kontekstin e vlerësimit të rreziqeve të parapara në nenin 41(6) të Ligjit,<sup>205</sup> dhe ishte vetëm një nga disa faktorë që u peshuan si "tërësi" kur Gjykatësja e Procedurës Paraprake shqyrtoi rrezikun e arratisjes së tij.<sup>206</sup>

## 2. Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

87. Paneli rikujton se kushtet e përcaktuara në nenin 41(6)(b) të Ligjit janë si alternativë e njëri-tjetrit.<sup>207</sup> Në qoftë se njëri nga këto kushte përmbushet, për vazhdimin e paraburgimit nuk është e nevojshme të shqyrtohen kushtet e tjera.

---

<sup>201</sup> Apeli, para. 67, që i referohet Vendimit të Apeluar, para. 25, poshtëshënimit 41. Shih gjithashtu Kundërpërgjigjen, para. 19.

<sup>202</sup> Apeli, para. 68; Kundërpërgjigjja, para. 19-22.

<sup>203</sup> Apeli, para. 69. Shih gjithashtu Kundërpërgjigjen, para. 22.

<sup>204</sup> Përgjigjja, para. 26, 31.

<sup>205</sup> Përgjigjja, para. 27. Shih gjithashtu Përgjigjen, para. 29-30.

<sup>206</sup> Përgjigjja, para. 29. ZPS-ja shton se ishte thënë shprehimisht se paketat e materialit të nxjerrë të përmendura ishin thjesht ilustruese dhe se nxjerrja e materialit të ZPS-së sipas rregullës 102(1)(b) të Rregullores në këtë çështje po vazhdon. Megjithatë, ZPS-ja thekson se, në listën e shembujve të materialit të nxjerrë të dhënë në Apel, Kilaj përfshiu një të dhënë të nxjerrë nga telefoni i tij mobil që vërteton praninë e tij në Hagë gjatë vizitës së tetorit 2023 në objektin e paraburgimit. Sipas ZPS-së, kjo tregon për procesin që po vazhdon të nxjerrjes së materialit relevant për akuzat në këtë çështje. Shih Përgjigjen, para. 27-28.

<sup>207</sup> Shih p.sh. Vendimin e Parë të Apelit mbi Paraburgimin e *Selimit* para. 76; Vendimin e Parë të Apelit mbi Paraburgimin e *Shalës*, para. 43.

Rrjedhimisht, nuk është e nevojshme të trajtohen gabimet e pretenduara nga Kilaj në lidhje me nenin 41(6)(b)(i) të Ligjit. Çfarëdo të jenë konstatimet e Panelit në lidhje me këto argumente, ato nuk ndikojnë në rezultatin e Vendimit të Apeluar, duke pasur parasysh se Paneli ka konstatuar se Gjykatësja e Procedurës Paraprake nuk ka gabuar në përfundimin për ekzistencën e rrezikut të pengimit sipas nenit 41(6)(b)(ii) të Ligjit, që e bën të domosdoshëm vazhdimin e paraburgimit.

88. Bazuar në sa më lart, rrëzohet Pika e Katërt e Apelit të Kilajt.

#### V. VENDIM

89. Për arsyet e lartpërmendura, Paneli i Dhomës së Gjykatës së Apelit:

**RRËZON** Apelin në tërësi. dhe

**URDHËRON** riklasifikimin si publike të Përgjigjes (IA004/F00003) dhe Kundërpërgjigjes (IA004/F00004), në përputhje me rregullën 82(5) të Rregullores.

/nënshkrimi/

**Gjykatëse Mishelë Pikar**

**Kryegjykatëse**

E hënë, 1 shtator 2025

Në Hagë, Holandë